



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA



QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

MINISTRY OF ENVIRONMENT
AND SPTAILA PLANNING

MINISTARSTVO SREDINE I
PROSTORNOG PLANIRANJA

VENDBANIMET JOFORMALE

Hulumtim i gjendjes ekzistuese Raport



Tetor 2005

Vendbanimet Joformale

Hartuesit e raportit për vendbanimet joformale

Në hartimin e këtij raporti kanë punuar profesionistë MMPH – Instituti për Planifikim Hapësinor, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Drejtoritë e Urbanizmit nëpër komuna ku është zhvilluar hulumtimi, UN-Habitati dhe Seksioni i Arkitekturës i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës. Më poshtë janë dhënë emrat e pjesëmarrësve:

Instituti për Planifikim Hapësinor:

1. Ilir Gjinolli
2. Faton Deva
3. Lendita Ajeti
4. Hazer Dana
5. Besim Avdyli
6. Bekim Kajtazi

Departamenti për Planifikim Hapësinor:

1. Astrit Hajrrullahu
2. Zeqavete Xheladini
3. Shkëndije Ballata, inspektore regjionale
4. Fadil Syla, inspektor regjional
5. Zejgiane Beshiri, inspektore regjionale

Komunat:

1. Muhamet Morina, Nazmie Tora, KK Prishtinë
2. Bedri Asllani, Gani Beshiri, KK Mitrovicë
3. Nesrete Ajroni, KK Gjakovë
4. Hamdi Ismaili, KK Gjilan

UN-Habitati:

1. Agron Sallova
2. Aida Dobruna
3. Lemane Hatashi
4. Ismajl Baftijari

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, UP:

1. Dukagjin Hasimja, Ligjërues
2. Jehona Valla
3. Afërdita Gashi
4. Arjeta Luta
5. Venera Haxhaj

Indeksi i terminologjisë dhe akronimeve

Vërejtje: Kjo listë e terminologjisë shërben për të pasë një kuptim unik të termeve dhe koncepteve. Këtu përfshihen termet e përgjithshme dhe termet specifike lidhur me vendbanimet joformale.

Fjala / Koncepti / Shkurtesa	Definicioni
AKK	Agjencioni Katastral i Kosovës
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
ARC	Komiteti Amerikan për Refugjatë
DÇBP	Drejtoria për Çështje të Banimet dhe Pronës
DPH	Departamenti i Planifikimit Hapësinor në MMPH
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor në MMPH
Ligji për planifikim hapësinor	Rregullorja 2003/14 e Kuvendit të Kosovës, Korrik 2003 dhe Rregullorja 2003/30 e UNMIK-ut Shtator 2003
MMPH	Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OJQ	Organizata joqeveritare
Plani Zhvillimor Urban (neni 14.1 i Ligjit për Planifikim Hapësinor)	Plani Zhvillimor Urban është plan strategjik multi-sektoral i cili përcakton synimet afatgjate për zhvillim dhe menaxhim të zonës urbane të qytetit për periudhën prej së paku pesë (5) viteve.
Plani Rregullues (neni 15.1 i Ligjit për Planifikim Hapësinor)	Planet e rregulluese urbane përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat e lokacionit të objekteve dhe ngastrat tokësore urbane.
PZSK	Plani për Zbatimin e Standareve për Kosovën
Qeverisja	Sistemi i vendimmarrjes për çështjet e përbashkëta. Koncepti është më i gjerë se qeveria dhe përfshinë edhe shoqërinë civile.
RAE	Romë, Ashkalinj dhe Egjiptas
VBJF	Vendbanimet Joformale
Zhvillimi formal	Zhvillimi në bazë të planit dhe rregullave të ndërtimit
Zhvillimi informal	Zhvillimi jashtë kornizës ligjore. Kjo nënkupton psh mosposedimin e formal të tokës, ose nuk ka leje ndërtimi ose shfrytëzimi për objektin në fjalë.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1. Sfondi
2. Qëllimet
3. Synimet
4. Elementet dhe kriteret e hulumtimit
5. Metodologjia e hulumtimit
6. Analiza e kontekstit politik dhe institucional
7. Analiza e kornizës ligjore dhe akteve rregulluese ekzistuese në lidhje me rregullimin e vendbanimeve joformale
8. Analiza e vendbanimeve jofromale (VBJF) të zgjedhura
 - **PRISHTINA**
 - **MITROVICA**
 - **GJAKOVA**
 - **GJILANI**
9. Konstatimet nga analiza
10. Rekomandimet për hartuesit e udhëzuesit dhe strategjisë për rregullimin dhe formalizimin e VBJF

SFONDI

Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për Standardin 6 – E Drejta Pronësore në vendbanimet joformale – Zbatimi i të drejtave pronësore është qenësor për të inkurajuar kthimet dhe trajtimin e barabartë të të gjitha bashkësive etnike. Vendbanimet informale janë definuar si vendbanime njerëzore të cilat, nuk u mundësojnë banorëve të vet t'i gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të jetesës, në veçanti banim adekuat. Si të tilla ato shquhen me karakteristikat si vijon:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuat ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuat ose mospjesëmarrje në qeverisje
- Rrezikshmëria deri në diskriminim

Në kuadër të standardit 6, është detyra 9.3 e cila duhet të ofrojë një vlerësim mbi gjendjen e vendbanimeve joformale në Kosovë dhe banorëve të tyre i cili do t'i paraqitet grupit të palëve të interesit.

Punët përgatitore për analizë të gjendjes ekzisuese në vendbanimet joformale, kanë filluar me themelimin e grupit të palëve me interes në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Ky, grup ka përcaktuar karakteristikat kryesore të vendbanimeve informale në Kosovë, në bazë të të cilave është kryer edhe hulumtimi në terren. Për ta realizuar hulumtimin në terren, janë propozuar katër qytete – Prishtina, Mitrovica, Gjakova dhe Gjilani. Në kuadër të komunës janë zgjedhur nga tri lagje të cilat kanë karakteristika të ndryshme. Janë propozuar edhe disa jashtë zonave urbane, por për shkakë sigurie nuk ka mundur të realizohet intervistimi.


Edhe pse standardi 6 – veprimet 8.3 dhe 9.3, kryesisht është i orientuar në zgjidhjen e problemeve të vendbanimeve joformale të grupeve etnike të rrezikuara – grupet etnike romë, ashkali dhe egjiptas, hulumtimi i përfunduar ka tentuar t'i gjejë elemente përcaktuese të vendbanimeve joformale edhe për lagje tjera të cilat duhet të shërbejnë si model për rregullimin e të gjitha vendbanimeve të tilla në Kosovë.

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të këtij hulumtimi janë:

- Plotësimi i kushtit të domosdoshëm të njohjes së gjendjes ekzistuese në të mirë të zbatimit sa më efikas të detyrave të dala nga PZSK-VI/8,9
- Sigurimi i bazës analitike për vlerësimin e gjendjes
- Njohja e modaliteteve të VBjF në tërë territorin e Kosovës
- Mundësimi i konsultimeve initiale mbi kërkesat e banorëve në VBjF

Vendbanimet Joformale



SYNIMET

- Përgatitja e raportit mbi gjendjen ekzistuese të VBJF në Kosovë.
- Përcaktimi i kriterëve për kategorizimin (determinimin) e vendbanimit si VBJF, konform definicionit të karakteristikave, të rekomanduara me PZSK dhe attributeve tjera urbane dhe hapësinore.
- Përcaktimi i treguesve me të cilët do të monitorohet përparimi në trajtimin e VBJF në Kosovë.

Elementet dhe kriteret e hulumtimit

Karakteristikat e VBJF sipas PZSK

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare
- Pjesëmarrja joadekuate ose mospjesëmarrja në qeverisje
- Rrezikshmëri deri në diskriminim

Atributet hapësinore

- Territori
- Popullsia
- Vendbanimi, rritja, zonat e zhvillimit të vazhdueshëm, zonat peri-urbane, zonat rurale
- Përcaktimi i vendbanimit për nga karakteri (urban apo rural)

Metodologjia e hulumtimit

Duke përdorë fotografitë ajrore, planet komunale në zbatim dhe shënime tjera hartografike dhe kadastrale duhet identifikuar territoret e kategorizuara si VBJF sipas kriterëve të lartpërmendura.

Për VBJF duhet analizuar:

- Konteksti në kuadër të qytetit
- Sipërfaqen e territorit që mbulon dhe popullatën
- Në raport me planin në zbatim karakterin e vendbanimit, rural apo urban.
- Karakteristikat e VBJF sikur janë të definuara me PZSK
- Veçori tjera karakteristike të VBJF

Paraprkishtë është krijuar:

- Një bazë të të dhënave për VBJF
- Përgatitur veglat e punës për ti pajisur planerët komunal për punë
- Prezentimi i shtrirjes hapësinore të VBJF në Kosovë
- Propozimi i kategorive për klasifikim të VBJF
- Identifikimi i grupit të VBJF me kërkesë urgjente për rregullim.
- Implikimet e punëve të planifikimit në procesin e rregullimit të VBJF
- Rekomandimet për elemente të cilat duhet marrë parasysh për hartimn e planeve të veprimt për rregullimin e VBJF etj.

Zbatimi i hulumtimit

Takimi i parë punues me komuna:

- Dhënia e udhëzimeve për identifikimin dhe analizën e VBJF.
- Qartësimi i kriterëve për hulumtim dhe analizë.
- Shpërndarja e veglave dhe materialeve tjera punuese.
- Dakordimi i referimit të punës pas një jave.

Periudha e punës II javore:

- Konsultimet në vazhdimësi me nivelin komunal mbi progresin dhe vështirësitë.
- Përgatitja e formatit të raportit të gjendjes ekzistuese të VBJF.

Takimi i dytë punues dhe konsolidimi i informatave:

- Rishikimi i punëve të kryera.
- Dakordimi i formës së raportit mbi gjendjen ekzistuese.

Hartimi i vlerësimit:

- Kategorizimi i VBJF për nga karakteristikat e dakorduara në përputhje me kriteret.
- Përpilimi i rekomandimeve për nxjerrjen e udhëzuesve dhe hartuesve të strategjisë.

ANALIZA E KONTEKSTIT POLITIK DHE INSTITUCIONAL

Me planin e Zbatimit të Standardeve për Kosovën (31 mars 2004) janë përcaktuar detajisht detyrat për arritjen e standardeve në pajtim me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si dhe me Kornizën Kushtetuese dhe Deklaratën origjinale të standardeve të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB. Gjithashtu, lidhur me deklaratën presidenciale të dates 12 qershor 2003 mbi Standardet për Kosovën, Këshilli i Sigurimit ka përsëritur mbizotërimin e rregulloreve të shpallura nga PSSP dhe të instrumenteve plotësuese si ligje të zbatueshme në Kosovë. Nuk do të zbatohet asnjë element diskriminues i legjislacionit pas 22 marsit 1989 që ka të bëjë me Kosovën. Standardet për Kosovën përforcojnë përparimin paralel të Kosovës drejt standardeve evropiane në kuadër të Procesit për Stabilizim dhe Asociim. Standardet parashohin një shoqëri multietnike, ku demokracia, toleranca, liria e lëvizjes, drejtësia u mundësohen të gjithë

Vendbanimet Joformale

banorëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

STANDARDI VI - E DREJTA PRONËSORE JURIDIKE

(shkëputur nga PZSK)

Veprimi 9, Detyra 9.2

Themelimi i një grupi të palëve të interesit për të përpiluar dhe mbikqyrur zbatimin e një strategjie afat-gjate dhe afatmesme dhe planit të punës për mbarë Kosovën (duke përfshirë legjislacionin zbatues) për rregullimin e vendbanimeve joformale bazuar në vlerësimin e bërë në 9.3

Veprimi 9, Detyra 9.3

Vlerësimi i kryer me ekspertët vendës ndërkombëtar mbi gjendjen aktuale të vendbanimeve joformale në Kosovë dhe banorëve të tyre i paraqitet grupit të themeluar në 9.2.

ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE DHE AKTEVE RREGULLUESE EKZISTUESE NË LIDHJE ME RREGULLIMIN E VENDBANIMEVE JOFORMALE

Rregullimi i vendbanimeve joformale në rrënjët të problemit është çështje e planifikimit hapësinor. Siguria e pronës, qasja në infrastrukturë adekuate, pjesëmarrja në qeverisje, mund të sigurohen përmes Planifikimit Urban – Zhvillimor dhe Rregullues. Ministria e Mjedisit ka përfunduar kornizën ligjore të planifikimit hapësinor. Është aprovuar Ligji mbi Planifikimin Hapësinor dhe janë hartuar aktet nënligjore të cilat e mundësojnë zbatimin e ligjit. Koncepti zhvillimor i planifikimit mundëson që me planet zhvillimore dhe rregulluese, komunat të vendosin për prioritetet e veprimit në përmirësimin e gjendjes së vendbanimeve joformale.

Miratimi i Ligjit të Ndërtimit i cili trajton çështjet e përgjithshme lidhur me ndërtimin, mundëson edhe trajtimin e ndërtesave. Për t'u mbështetur me rregullore dhe udhëzues trajtimi i ndërtimit ilegale, MMPH ka filluar hartimin e Ligjit mbi Ndërtimet Ilegale. Ky ligj do të mundësojë rregullimin e ndërtimeve pa leje, kurse përmes taksave të ndërtimit, do të mundësojë financimi i infrastrukturës teknike dhe sociale.

HULUMTIMI

I. HULUMTIMI PËRMES PYETËSORIT

Intervistimi përmes pyetësorit nëpër komuna ka filluar me 15 06 2005 dhe ka zgjatur deri më 15 07 2005, kurse, udhëheqësit e grupeve kanë punuar deri më 22 07 2005 në futjen e të dhënave në databazën e krijuar në Institutin për Planifikim Hapësinor. Sipas planit të veprimit të paraparë në fillim të projektit, kanë qenë të parapara nga tri vendbanime informale në katër qytetet e mëdha të Kosovës, kurse në Prishtinë është shtuar një më shumë.

- I. **Në Prishtinë është punuar në këto lokacione:** lagjja “Ramiz Sadiku”, lagjja Dodona” lagjja “Kodra e Trimave”/Vranjevci
Numri i shtëpive të hulumtuara është:
 1. Lagjja Ramiz Sadiku - 167 pyetësorë
 2. Lagjja Dodona - 252 pyetësorë
 3. Lagjja Kodra e trimave – 435 pyetësorëNë total në Prishtinë janë hulumtuar - 854 objekte

II. Në Mitrovicë është punuar në këto lokacione: lagjja “2 Korriku”, lagjja “Kroi i Vitakut” (Rruga e Sitnicës), lagjja “Mahalla e Romëve”

Numri i shtëpive të hulumtuara është:

1. Lagjja “2 Korriku” - 180 pyetësorë
2. Lagjja “Kroi i Vitakut” - 27 pyetësorë
3. Lagjja “Mahalla e Romëve” – 231 pyetësorë

Në total në Mitrovicë janë hulumtuar - 438 objekte

III. Në Gjakovë është punuar në këto lokacione: Lagja Piskota /Dardania, Lagja Kolonia, dhe Lagja Berkoci,

Numri i shtëpive të hulumtuara është:

1. Lagjja Piskota /Dardania -8 pyetësorë
2. Lagjja Kolonia -111 pyetësorë
3. Lagjja Brekoci -157 pyetësorë

Në total në Gjakovë janë hulumtuar 276 objekte

IV. Në Gjiilan është punuar në këto lokacione: lagjja “Abdullah Presheva”, lagjja: Te Stacioni i Autobuseve (Rruga “Marie Shllaku”, lagjja “Zabeli i Sahit Agës”

Numri i shtëpive të hulumtuara është:

1. Lagjja “Abdullah Presheva” - 125 pyetësorë
2. Lagjja “Te Stacioni i Autobuseve”(Rruga “Marie Shllaku”) - 68 pyetësorë
3. Lagjja “Te Zabeli i Sahit Agës” – 443 pyetësorë

Në total në Gjiilan janë hulumtuar - 636 objekte

Numri i përgjithshëm i të gjitha objekteve të hulumtuara në këto katër qytete është 2204.

Problemet:

Gjatë hulumtimit, sipas raportimit të grupeve punuese në terren, bashkëpunimi me qytetarët e intervistuar ka qenë i mirë. Pasi që nuk ka qenë i caktuar numri i objekteve të cilat do të trajtoheshin, është hasur në vështirësi të ndryshme, sidomos nga mosprezenca e pronarëve të shtëpive.

- Në lagjen “Mahalla e Romëve” në Mitrovicë është bërë vetëm fotografimi i objekteve sipas kodeve të përgatitura nga Ministria pasi që shtëpitë janë të shkatërruara dhe pronarët jetojnë në anën veriore apo jashtë shtetit.
- Në lagjen “Kroi i Vitakut” nuk ka mundur të shkohet për shkak të sigurisë, edhe pse disa herë është kërkuar siguri i grupit të studentëve nga autoritete e UNMIK-ut, në Regjionin e Mitrovicës. Për të njëjtën arsye nuk ishte e mundur të shkohet në kampin Zhitkovc dhe Çeshmin Llug, në anën veriore të Mitrovicës.
- Poashtu, për shkak të sigurisë, nuk ka qenë e mundur të shkohet në Graçanicë për të intervistuar banorët.

Pengesat tjera gjatë kryerjes së punës kanë qenë:

- Vonesa e ortofotove nga AKK
- Moti i lig
- Vëllimi i paparashikuar i punës në terren është reflektuar zgjatjen e kohës për futjen e të dhënave në databazë.

PRISHTINA

Në fillim të hulumtimit në Komunën e Prishtinës kanë qenë të parapara për hulumtim katër vendbanime joformale. Për shkak të mosorfimit të sigurisë nga UNMIK-u, nuk ka qenë e mundur shkuarja në Graçanicë për të hulumtuar vendbanimin e romëve. Natyra dhe mënyra e krijimit të vendbanimeve joformale në Komunën e Prishtinës ka diktuar që të zgjedhen tri vendbanime joformale të cilat shquhen me karakteristika themelore të ndryshme në mes veti: Lagja “Dodona” (ish “Moravska”), “Kodra e Trimave” (ish “Vranjevci”) dhe lagja “Kolonja Ramiz Sadiku”.

Karakteristikat themelore të këtyre tri vendbanimeve rrjedhin nga periudha kohore e krijimit, mënyra e krijimit si dhe mënyra e posedimit të pronës. Kjo d.m.th. se në Prishtinë nuk mund t'i konsiderojmë si raste të ngjashme, prandaj edhe mënyra e trajtimit të tyre do të ndryshojë. Në Prishtinë të katër elementet përcaktuese të vendbanimeve joformale janë prezente:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje
- Rrezikshmëria deri në diskriminim

Përbërja etnike e lagjeve është e përzier, por në lagjen “Dodona”, banorët e paraluftës janë kryesisht të komunitetit rom. Ndërsa dy lagjet tjera janë të dominuara nga shqiptarët.

Mungesa e shërbimeve themelore është e shprehur në lagjen “Dodona” dhe në “Kodrën e Trimave”, kurse në lagjen “Kolonja Ramiz Sadiku” shërbimet themelore janë të siguruar, por zotërimi joformal i pronës paraqet problem lidhur me përparimin e kushteve fizike të ndërtesave, pasi që prona mbi tokën është kryesisht publike – komunale, kurse banorët i zotërojnë vetëm banesat të cilat janë privatizuar në vitet '90-ta.

Qasja joadekuate infrastrukturë teknike i karakterizon “Dodonën” dhe “Kodrën e Trimave”. Kanalizimi joadekuat, mungesa në shumicën e shtëpive, mungesa e kanalizimit atmosferik, mungesa e ujësjellësit si dhe infrastruktura rrugore joadekuate, me profil të ngushtë dhe pa hapësirë të ndarë për këmbësorë.

Arsimi parashkollor dhe fillor, edhe pse për të gjitha lagjet është në afërsi – numri i nxënësve që gravitojnë në to, e ulin dukshëm kualitetin e zhvillimit të procesit mësimor. Mirëpo, këto janë probleme të përbashkëta të të gjitha qyteteve në Kosovë, kurse të Prishtinës posaçërisht për shkak të migrimit të madh të popullatës nga pjesët tjera të Kosovës.

Mungesa e shërbimeve dhe mundësitë e vogla të Komunës për t'i përmirësuar ato, e ulë motivimin e qytetarëve për të qenë pjesëmarrës në qeverisje dhe në artikulimin e nevojave dhe kërkesave për rregullimin urban të lagjeve.

Për shkak të ngarkesës me punë të Drejtorisë së Kadastrit, përpilimi i evidencës pronësore në kuadër të VBJF (fletë poseduese dhe kopje e planit) nga Drejtoria i Urbanizmit nuk ka qenë e mundur të kryhet.

Autoritetet komunale janë duke punuar në hartimin e planeve rregulluese për tërë qytetin. Gjatë këtij dhe vitit atij të ardhshëm do të përfundojnë planet rregulluese për lagjet e hulumtuara.

Vendbanimet Joformale

Nr.	Vendbanimi / emërtimi	Urgjenca		Plani që e rregullon			Madhësia		Konteksti urban/rural		
		ASH / AM / AGJ		PZHK / PZHU / PRRU			v / m / M		U / UR / R		
1	"Dodona"	X				X	X		X		
2	Kolonia "R. Sadiku"	X				X	X		X		
3	"Kodra e Trimave"	X				Pjesërisht		X	X		

ASH - Afat
shkurtë AM -
Afat mesëm
AGJ - Afat gjatë

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
PZHU - Plani Zhvillimor Urban
PRRU - Plani Rregullues Urban

v - I vogël
m - I mesëm
M - I madhë

U - Urban
UR - Urban Rural
R - Rural


Gjendja socio-ekonomike - Të gjithë indikatorët tregojnë për një gjendje të vështirë sociale dhe ekonomike dhe me shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Rreth gjysma e familjeve nuk kanë të ardhura të sigurta, por edhe ato të ardhura nuk mjaftojnë as për sigurimin e kërkesave elementare të ekzistencës, që tregon shkallë të lartë të varfërisë dhe rreth 20 % e familjeve të cilat nuk kanë kurrfarë të ardhurash dhe janë me asistencë sociale, tregon se këto familje janë në varfëri ekstreme.

Të dhënat tregojnë edhe për shkallë të lartë të papunësisë. Rreth 43 % e familjeve nuk kanë të punësuar asnjë anëtar, 16 % e familjeve kanë anëtarë të punësuar përkohësisht, dhe 41 % e familjeve kanë anëtarë të punësuar, por anëtarët e familjes që i takojnë grupëmoshës 18 – 65 vjeç (popullsia e aftë për punë) përfshin rreth 62 %, që do të thotë se në mesataren e familjes prej 6.5 anëtarë, rreth 4 anëtarë të familjes janë popullsi aktive që janë të aftë për të punuar, prandaj edhe ato familje të cilat kanë të punësuar anëtar, nuk i kanë të punësuar të gjithë anëtarët që janë të aftë për punë.

Niveli i ulët arsimor (8 % student dhe 7 % me shkollim të lartë), është indikator i cili ndikon në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik si dhe në shkallën e papunësisë dhe varfërisë.

Dominimi i familjeve të mëdha dhe të zgjeruara, tregon gjithashtu shkallë të ulët të zhvillimit dhe arsimit dhe papunësi e varfëri të theksuar.

BANIMI - Gjendja e banimit nuk është e mirë dhe kjo tregohet nga përgjigjet që janë marrë sa i përket kësaj çështje.



34 % - e mirë

28 % - mesatare

22 % - e dobët

11 % - e papreferueshme

6 % - e shkatërruar

Rreth 40 % e rasteve tregojnë se gjendja e banimit është e dobët, e pa preferueshme apo edhe e shkatërruar. Sa i përket kushteve të banimit 77 % e shtëpive kanë kushte të

banueshme, ndërsa 23 % e shtëpive nuk kanë kushte për banim. Po ashtu rreth 77 % e shtëpive janë ndërtuar pas viteve 1970, ndërsa pjesa tjetër para viteve 1970 që do të thotë se edhe vjetërsia e objekteve të banimit është element që ndikon në kushtet e banimit. Objektet e banimit janë kryesisht një katëshe (42 %), 1 % janë 1.5 katëshe, 34 % janë 2 katëshe dhe rreth 12 % trikatëshe, që pasqyron hapësirë të vogël banimi për faktin se këtu kemi familje të mëdha (me numër të madh të anëtarëve).

Sa i përket pronësisë, rreth 65 % e rasteve janë pronar që do të thotë pjesa dërmuese, ndërsa banim me qira dhe në pronë shoqërore kemi shumë pak raste, por rastet e joposeditimit dhe uzurpimit (rreth 11 %), parqesin anën tjetër negative që kërkojnë zgjidhje urgjente.

Vendbanimet Joformale



Pozita e vendbanimeve joformale në kuadër të qytetit të Prishtinës

Problemet e këtyre vendbanimeve janë probleme të cilat janë identifikuar në shumë lagje të cilat janë zhvilluar pa plan. Edhe pse Prishtina ka aprovuar planin strategjik, problemet e shërbimeve themelore, përveç transportit publik, nuk janë adresuar në mënyrë të qartë. Rritja shumë e madhe e numrit të popullsisë i bënë sistemet e infrastrukturës, edhe ashtu të vjetra, të mos funksionojnë mirë.

Lagja “Dodona” (ish rr. “Morava”)**POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI**

Lagja “Dodona” shtrihet në pjesën qendrore të qytetit. Zanafilla e saj është nga periudha e para Luftës së Dytë Botërore. Për shkak të rritjes së qytetit kjo lagje tani i përket pjesës qendrore. Aktualisht komuna është në fazën përgatitore për hartimin e planit rregullues të lagjes.



*Pamje e
lagjes
“Dodona”*

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuata ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuata ose mospjesëmarrje në qeverisje

PRONËSIA MBI TOKËN

Në kuadër të lagjes ka pronësi publike dhe private. Dokumentacioni kadastral ekziston dhe disa prej pronarëve i kanë fletat poseduese.

Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 9.16ha.

- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Prishtinës është në fazën e përgatitjes të planit rregullues, prandaj mund të konsiderohet se lagja është konsideruar për rregullim emergjent. Kjo do të mundësonte kthimin e personave të zhvendosur.

Vendbanimet Joformale

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të madhe ndërtimi, kurse mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i saj shkakton probleme të mjedisit.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës mund të ketë probleme për shkak të pjerrtësisë së terrenit.

KLIMA

- Për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi.
- Meqenëse lokacioni është i kthyer nga veriu, ndikimi i erërave është më i shprehur, për shkak se në Prishtinë dominojnë erërat nga verilindja.
- Insolimi nuk është i volitshëm për shkak të pjerrtësisë kah ana veriore.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes është dinamike me një ndryshim të prej afër 50 m'. Terreni i pjerrtë mund të ndikojë negativisht

NDIKIMI I MJEDISIT

- Afërsia e parkut të qytetit ka një rëndësi për lagjen. Qasja e kufizuar në park në një masë e mbron biodiversitetin e parkut.
- Edhe pse hulumtime detaje nuk janë bërë, por shtëpitë të cilat furnizohem me ujë nga pusi mund të kenë ndikim nga mungesa e kanalizimit në lagje.
- Mungesa e kanalizimit atmosferik shkakton vërshime gjatë shirave të mëdha.

PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësirat e dedikuara për rrugë janë të pamjaftueshme për funksionim të mirë të qarkullimit në kuadër të lagjes.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate, Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik është në distancë të madhe
- Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese –shkollë, çerdhe apo objekt shëndetësor. Këto përmbajtje janë në afërsi dhe mund të konsiderohet se arsimi, shëndetësia, puna, tregtia
- Densiteti-numri i shtëpive për hektarë, sipërfaqja e ndërtuar për hektarë.

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është joadekuate. Mungon furnizimi me ujë në të gjitha shtëpitë. Të gjitha shtëpitë nuk janë të lidhura me kanalizim
- Për shkak të pozitës qendrore të lagjes në qytet, afërsia e vijave primare të infrastrukturës mundëson që përparimi i infrastrukturës të jetë më i lehtë.



*Pamje e një
rruge në
lagjen
“Dodona”*

Vendbanimet Joformale

Lagja – “Kolonja Ramiz Sadiku”

POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI

Lagja “Kolonja Ramiz Sadiku” shtrihet në pjesën qendrore të qytetit. Në bazë të shënimeve ekzistuese, shihet se ky vendbanim ka eksistuar si pjesë e lagjes së urbanizuar të qytetit qysh nga vitet e '60-ta dhe ka pasë destinim për shërbim të nevojave të punëtorëve KNI “Ramiz Sadiku”. Sipas informatave nga zyrtarë komunal, lagja ka patur karakterin e përkohshëm. Më vonë në vitet e '80-ta, struktura e ndërtimit mbetet e njëjtë, por objektet e kësaj lagjeje kanë filluar të marrin destinimin e banimit familjar. Aktualisht në kohën e sotme, struktura e objekteve të kësaj lagjeje ka ndryshuar në ndërtim të pakontrolluar, me forma dhe lartësi të ndryshme dhe me destinim të shfrytëzimit privat dhe për afarizëm.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje



Pamje e lagjes “Kolonja Ramiz Sadiku”

PRONËSIA MBI TOKËN

- Në kuadër të lagjes, shumica e pronës është publike dhe private. Dokumentacioni kadastral ekziston dhe disa prej pronarëve i kanë fletat poseduese.
- Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca rreth 2.3 ha; (numri i ngastrës Nr.127/1)
- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Prishtinës ka bërë analizën dhe shqyrtimin e kësaj zone dhe ka konsideruar se kjo pjesë e qytetit duhet urgjentisht ta ketë Planin Rregullues Urban. Kjo do të mundësonte rregullimin dhe përmirësimin e kualitetit të jetës në lagje.

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të madhe ndërtimi, me objekte të ndërtuara në formë të pakontrolluar, me lartësi të ndryshme, me destinim shfrytëzimi publik, afarist dhe privat. Përderisa, mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i saj shkakton probleme të mjedisit.

KUSHTET GJEOLOGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi i objekteve është me lartësi dhe forma të ndryshme.

KLIMA

- Për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi.
- Lokacioni i lagjes “Kolonia Ramiz Sadiku” gjendet në pjesën qendrore të qytetit në drejtim të jug-perëndimit, andaj ndikimi i erërave nuk është shumë i shprehur, për shkak se në Prishtinë dominojnë erërat nga verilindja.
- Insolimi nuk është i volitshëm për shkak të pjerrtësisë kah ana veriore.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes “Ramiz Sadiku” është me karakteristika topografike kryesisht të pandryshueshme. Terreni është kryesisht i rrafshët, ka një pjerrtësi shumë të vogël në kuadër të lokacionit të vetë lagjes.

NDIKIMIT NË MJEDIS

- Lagja “Kolonia Ramiz Sadiku” nuk ka ndikim të madh në mjedisin në të cilin gjendet, për shkak se edhe pse gjendet në afërsi të ngushtë të qendrës së qytetit, ka një sipërfaqe relativisht të vogël (rreth 2.3 ha), dhe me llojet e ndryshme të ndërtimeve dhe llojet e ndryshme të shërbimeve sociale dhe afariste të cilat zhvillohen brenda saj, ndikimi negativ në mjedis është i vogël. Mirëpo frekuenca e qarkullimit të automjeteve shkakton ndotjen e ajrit nga tymi dhe pluhuri.

PLANIFIKIMI

- Përshkrimi i vendbanimit: Gjendja aktuale e ndërtimit në këtë lagje është ndërtim i kombinuar privat individual dhe shfrytëzim afarist i disa objekteve. Infrastruktura teknike dhe sociale është pjesërisht e zhvilluar. Andaj, zhvillimi i mëtutjeshëm i kësaj lagjeje është ngushtë i lidhur me Planin Rregullues Urban të cilin Komuna e Prishtinës duhet ta nxjerrë së shpejti.
- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësira publike të cilat kanë shfrytëzim për afarizëm. Hapësira e dedikuara për rrugë janë shumë të vogla, hapësirat e trotuareve janë të ngushta dhe sipërfaqet për parkim janë në mungesë sidomos të objektet me shfrytëzim publik dhe afarist.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate, Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik është në afërsi, pasi që kjo lagje gjendet në zonën e ngushtë qendrore të qytetit të Prishtinës.

Vendbanimet Joformale

- Lagjja posedon edhe përmbajtje shërbyese si: shkollën fillore në afërsi të vetë lagjes, ambulancën shëndetësore gjithashtu në afërsi të lagjes, si dhe 2 çerdhe të cilat gjinden në lagjet në fqinjësi.
- Densiteti i banimit në lagjen “Ramiz Sadiku” është i madh, me rreth 100 njësi banimi individual, 11 njësi banimi kolektiv, dhe 10 lokale afariste në sipërfaqe rreth 2.3 ha. -60 njësi /ha.



Pamje e një rruge në lagjen “Kolonja Ramiz Sadiku”

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është joadekuate, llojet e ndryshme të shërbimeve të infrastrukturës nuk janë njëjtë të shpërndara në tërë lagjen.
- Për shkak të pozitës qendrore të lagjes në qytet, afërsia e vijave primare të infrastrukturës mundëson që përparimi i infrastrukturës të jetë më i lehtë.

Lagja – “Kodra e Trimave”**POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI**

Megjithse nuk ka kufizim të qartë se çka paraqet lagja “Kodra e Trimave”, hulumtimi është përqëndruar në njërën pjesë e cila sipas informatave konsiderohet si pjesa më e vjetër e saj, pra që nga zanafilla e vendosjes së banorëve të shpërngulur nga zona përreth liqenit të Batllavës. Lokacioni i lagjes shtrihet në pjesën periferike të qytetit të Prishtinës. Sipas të dhënave mësohet se kjo lagje ka ekzistuar në vietet e '60-ta dhe ka patur një sipërfaqe shumë të vogël.

Sipas shënimeve nga vitet e '80-ta kjo lagje është zhvilluar me ndërtim të pakontrolluar dhe një strukturë të shpërndarë të shtëpive, dhe me infrastrukturë teknike dhe sociale të pamjaftueshme. Në kohën e sotme kjo lagje ka pësuar një zgjerim të theksueshëm të saj, me strukturë të ndryshueshme të objekteve, forma dhe lartësi të ndryshme, dendësi të madhe, me banim individual dhe publik si dhe me shfrytëzim të objekteve për afarizëm, por megjithatë ende ka mbetë zonë e paurbanizuar e qytetit. Aktualisht, komuna ka bërë analizën dhe hulumtimin e kësaj lagjeje dhe ka dhënë propozimin për hartimin e Planit Urban Rregullativ për këtë zonë.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuate në shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate dhe mospjesëmarrje në qeverisje



Pamje e një rruge në lagjen “Kodra e Trimave”

Vendbanimet Joformale

PRONËSIA MBI TOKËN

- Në kuadër të lagjes ka pronësi publike dhe private. Dokumentacioni kadastral ekziston dhe disa prej pronarëve i kanë fletat poseduese
- Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 9.16 ha
- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Prishtinës ka bërë analizën dhe shqyrtimin e kësaj lagjeje dhe e kanë konsideruar urgjente hartimin e planit rregullues urban për këtë zonë.

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të madhe ndërtimi, kurse mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i saj shkakton probleme të mjedisit. Në shumë pjesë të kësaj lagjeje nuk ka as furnizimi me ujë nga sistemi i ujësjellësit e as kkanalizim të ujërave të zeza.
- Kanalizimi atmosferik nuk ekziston po ashtu dhe ky është një faktor që ndikon në vërshimin e rrugëve nga shirat e mëdha.



Pamje e një rruge ne lagjen “Kodra e Trimave”

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ultë, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejme në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Infrastruktura është shumë e varfur dhe ka zhvillim simbolik në këtë lagje, prandaj kjo lagje konsiderohet e paurbanizuar.

KLIMA

- Për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, e sidomos të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi.
- Meqenëse lokacioni është i kthyer nga veriu, ndikimi i erërave është më i shprehur, për shkak se në Prishtinë dominojnë erërat nga verilindja.
- Insolimi nuk është i volitshëm për shkak të pjerrtësisë kah ana veriore.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes “Kodra e Trimave” është me karakteristika topografike kryesisht të pandryshueshme. Terreni është kryesisht i rrafshët, ka një pjerrtësi shumë të vogël në kuadër të lokacionit të vetë lagjes. Terreni i pjerrët mund të ketë ndikim relativisht negativ në zhvillimin e mëtutjeshëm të lagjes.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

- Pozita e lagjes në periferi të qytetit të Prishtinës, rezulton me ndikim relativ në mjedis, në kuadër të zonës urbane kjo lagje me densitetin e madh të banimit që ka dhe zhvillimin e dobët të shërbimeve të infrastrukturës mund të ketë ndikim negativ në mjedis, por me kontrollimin e zhvillimit të saj mund të ndikohet pozitivisht në zhvillimin e pjesës periferike të qytetit.
- Edhe pse hulumtime detaje nuk janë bërë, shtëpitë të cilat nuk janë të kyçura në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit mund të kenë ndikim negativ në ndotjen e ambientit në zonën e kësaj lagjeje.
- Mungesa e kanalizimit atmosferik shkakton vërshime gjatë shirave të mëdha.

PLANIFIKIMI

- Përshkrimi i vendbanimit: Ndërtimi në këtë lagje është ndërtim i kombinuar privat individual dhe një numër më i vogël i objekteve më shfrytëzim afarist, infrastruktura teknike dhe sociale ka zhvillim të pjesërisht. Andaj zhvillimi i mëtutjeshëm i kësaj lagje është ngusht i lidhur me planin rregullues urban të cilin Komuna e Prishtinës duhet ta hartojë së shpejti. Me këtë plan parashihet rregullimi i zhvillimit të mëtutjeshme të lagjes, sigurimin e shërbimeve të nevojshme të infrastrukturës teknike dhe sociale.
- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësirat e dedikuara për rrugë janë të pamjaftueshme bazuar në kërkesat sipas dendësisë së banimit, hapësira e sipërfaqeve për parkim janë të pamjaftueshme.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate. Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik kalon nëpër rrugën e cila qon për Podujevë. Megjithatë, funksionimi i tij vetëm në këtë rrugë nuk mundëson qarkullim të lehtë deri në pjesët tjera të qytetit gjë që ndikon në qasjen në shërbimet tjera në kuadër të qytetit..
- Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese – shkollë, çerdhe apo objekt shëndetësor. Këto përmbajtje janë në afërsi dhe mund të konsiderohet se arsimi, shëndetësia, puna, tregtia janë shërbime dhe aktivitete të cilat duhet të sigurohen dhe zhvillohen në kuadër të vetë lagjes. Në afërsi të lagjes gjenden 2 shkolla fillore, në një distancë më të largët gjendet një objekt shëndetësor i cila siguron shërbimet themelore, ndërsa çerdhe të fëmijëve nuk ka as në lagjet fqinje.

Vendbanimet Joformale

- Densiteti i banimit në pjesën e hulumtuar në lagjen “Kodra e Trimave” është shumë i madh. Në sipërfaqe prej 10.31 ha ka rreth 800 familje, ose 77 shtëpi/ha




Pamje e një rruge në lagjen “Kodra e Trimave”

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është joadekuatë. Mungon furnizimi me ujë në të gjitha shtëpitë, të gjitha shtëpitë nuk janë të lidhura me kanalizim, furnizimi me energji elektrike nuk i plotëson kërkesat, etj.
- Për shkak të pozitës periferike të lagjes në qytet, afërsia e vijave primare të infrastrukturës mundëson që përparimi i infrastrukturës të jetë më i lehtë.

Vendbanimet Joformale



Rrezja e shërbimeve të infrastrukturës sociale në raport me vendbanimet joformale në qytetin e Prishtinës

MITROVICA

Drejtoria e Urbanizmit të qytetit të Mitrovicës ka vendosur që për hulumtimin e vendbanimeve joformale të marrë tri vendbanime karakteristike, për kah krijimi, përbërja etnike dhe gjendja fizike e tyre. Derisa “2 Korriku” paraqet një lagje me përbërje etnike mikste, dy lagjet tjera – “Mahalla e Romëve” dhe “Kroi i Vitakut” janë me përbërje etnike rome, respektivisht përbërje etnike shqiptare. Pasojat shkatërrimtare të luftës mund të shihen vetëm në lagjet etnikisht të pastra. “Mahalla e Romëve” dhe “Kroi i Vitakut” janë të shkatërruara në tërësi dhe popullata e tyre është e zhvendosur.

Hulumtimi në qytetin e Mitrovicës nuk ka mundë të zhvillohet si ka qenë e paraparë me plan. Hulumtimi është kompletuar vetëm në lagjen “2 Korriku”. Në lagjen “Mahalla e Romëve” janë marrë vetëm të dhënat fizike, kurse intervistimi i banorëve të lagjes të cilët janë në pjesën veriore të qytetit nuk ka qenë e mundur të realizohet për shkaqe të sigurisë. Po ashtu edhe lagja “Kroi i Vitakut” nuk ka mundur të vizitohet për shkak të sigurisë.

Të tri këto vendbanime karakterizohen me:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje

Kurse lagjet “Mahalla e Romëve” dhe “Kroi i Vitakut” shquhen edhe me

- Rrezikshmëri deri në diskriminim, të popullatës, për shkak të pamundësisë së kthimit të banorëve në shtëpitë e rrënuara.

Shërbimet joadekuate të infrastrukturës teknike dhe sociale janë karakteristikë të tri vendbanimeve. Informatat më detaje janë prezentuar në databazën e shënimeve, kurse në hartën e rrezes së shërbimeve të shkollave, çerdheve dhe objekteve shëndetësore janë treguar raportet me lagjet e hulumtuara.

Problemi i qytetit të ndarë në Mitrovicë e vështirëson edhe pozitën e vendbanimeve joformale. Ky problem i favorizon uzurpimet e pronës.

Për shkak të ngarkesës me punë të Drejtorisë së Kadastrit, përpilimi i evidences pronësore në kuadër të VBjF (fletë poseduese dhe kopje e planit) nga Drejtorati i Urbanizmit nuk ka qenë e mundur të kryhet.

Nr.	Vendbanimi / emërtimi	Urgjenca		Plani që e rregullon			Madhësia			Konteksti urban/rural		
		ASH / AM / AGJ		PZHK / PZHU / PRRU			v / m / M			U / UR / R		
1	2 Korriku	X						X		X		
2	Mahalla e Romëve	X				X		X		X		
3	Kroi i Vitakut	X					X				X	

ASH - Afat shkurtë AM - Afat mesëm AGJ - Afat gjatë

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
PZHU - Plani Zhvillimor Urban
PRRU - Plani Rregullues Urban

v - I vogël
m - I mesëm
M - I madhë

U - Urban
UR - Urban Rural
R - Rural

Gjendja sociale dhe ekonomike paraqitet shumë kritike, ku shkalla e varfërisë dhe papunësisë është shumë e lartë. Rreth 40 % e familjeve janë me asistencë sociale dhe pa të ardhura, që

do të thotë se të gjitha këto familje janë në varfëri ekstreme. Gjendja sociale dhe ekonomike paraqitet shumë kritike, ku shkalla e varfërisë dhe papunësisë është shumë e lartë. Rreth 40 % e familjeve janë me asistencë sociale dhe pa të ardhura, që do të thotë se të gjitha këto familje janë në varfëri ekstreme.

Të dhënat tregojnë edhe për shkallë të lartë të papunësisë. Rreth 65 % e familjeve nuk kanë të punësuar asnjë anëtar, 14 % e familjeve kanë anëtar të punësuar përkohësisht, dhe 20 % e familjeve kanë anëtar të punësuar, por jo të gjithë anëtarë të cilët janë të aftë për punë. Niveli shumë i ulët arsimor, ku mbi 50 % e popullsisë nuk kanë shkollën e mesme, ndërsa pa shkollë fillore rreth 25 %, parqet problem serioz dhe është i domosdoshëm përmirësimi i gjendjes arsimore, me qëllim të përmirësimit të gjendjes ekonomike e sociale. Niveli i ulët arsimor është edhe më i shprehur te gjinia femërore, dhe kjo reflektohet me pasoja edhe në punësimin e gjinisë femërore.

Pjesëmarrja e gjinive sipas sektorëve tregon se gjinia mashkullore është e punësuar më shumë në sektorin privat se në atë shoqëror, ndërsa gjinia femërore është e punësuar më shumë në sektorin shoqëror.

Punësimi i gjinisë femërore në dy sektor është jashtëzakonisht i ulët, dhe mund të themi se në këto familje punësimi i femrës është shumë i kufizuar, dhe atë kryesisht për shkak të nivelit të ulët arsimor.

Dominimi i familjeve të mëdha, tregon gjithashtu shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik dhe arsimor me papunësi e varfëri të theksuar. Mesatarja e anëtareve të familjes është 6 anëtarë, dhe afër 60 % janë popullat aktive (e aftë për punë).


Gjendja e banimit nuk është e mirë dhe kjo tregohet nga përgjigjet që janë marrë sa i përket kësaj çështje.

- 10 % - e mirë
- 9 % - mesatare
- 16 % - e dobët
- 4 % - e papreferueshme
- 61 % - e shkatërruar

Rreth 60 % e rasteve tregojnë se gjendja e banimit është e shkatërruar. Rreth 77 % e shtëpive janë ndërtuar pas viteve 1970, ndërsa pjesa tjetër para viteve 1970 që do të thotë se edhe vjetërsia e objekteve të banimit është element që ndikon në kushtet e banimit.

Objektet e banimit janë kryesisht një katëshe (72 %), 25 % janë 2 katëshe, që pasqyron hapësirë të vogël banimi për faktin se këtu kemi familje të mëdha (me numër të madh të anëtarëve).

Sa i përket pronësisë, rreth 30 % janë pronar, por 60 % nuk kanë dhënë përgjegje, por rastet e joposedimit dhe uzurpimit (rreth 10 %), parqesin anën tjetër negative që kërkon zgjidhje urgjente.



Vendbanimet Joformale



Pozita e vendbani-meve joformale në kuadër të qytetit të Mitrovicës

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor – Insituti për Planifikim Hapësinor

Lagja “2 Korriku”**POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI**

Lagja “2 Korriku” shtrihet në pjesën qendror dhe verilindore të qytetit të Mitrovicës. Zanafilla e saj është nga periudha e parë e Luftës së Dytë Botërore. Lagja është zhvilluar pa ndonjë plan rregullues.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë (26% - raste të joposedimit dhe uzurpimit)
- Qasje joadekuata ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuata ose mospjesëmarrje në qeverisje

PRONËSIA MBI TOKËN

Posedimi i pronës në kuadër të lagjes është kryesisht privat. Dokumentacioni kadastral ekziston në drejtorinë e kadastrit dhe në bazë të deklaramentit, pjesa dërmuese e pronarëve i kanë fletat poseduese. Mbi 15% e rasteve janë pronë jo e poseduar, kurse 11% janë raste uzurpimi në tërë lokacionin.

- Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 20.4 ha
- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Mitrovicës është në fazën e përgatitjes për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Urban.



Pamje
e
lagjes
“2
Korriku

Vendbanimet Joformale

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të vogël ndërtimore, me shumë sipërfaqe të pandërtuar.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Ndërtimi i infrastrukturës nuk është i indikuar nga kushtet gjeologjike.

KLIMA

- Për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi.
- Meqenëse lokacioni shtrihet përgjatë shtratit të lumit Sitnica, rrymimet ajrore e bëjnë lokacionin me një klimë më të freskët.
- Insolimi është i volitshëm për shkak dendësisë së vogël.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes është dinamike me një ndryshim prej afër 50m'. Terreni i pjerrtë mund të ndikojë negativisht në infrastrukturë.

NDIKIMI NË MJEDIS

- Edhe pse hulumtime detaje nuk janë bërë, por kanalizimi me grova septike mund të ndikojë në ujin e puseve të cilat shfrytëzohen në lagje.
- Ndotja e ajrit dhe tokës është rezultat i industrisë së rëndë në kompleksin e Trepçës. Afërsia e kompleksit të industrisë së akumulatorëve dhe plehërave kimike, me deponinë e mbeturinave industriale, përbëjnë burimin kryesor të ndotjes jo vetëm për lagjen "2 Korriku", por për tërë qytetin dhe rrethinën e Mitrovicës.

PLANIFIKIMI

Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësirat e dedikuara për rrugë.

Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate, Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik është në distancë të madhe dhe ai kryesisht kalon në rrugën e cila lidhë qendrën me magjistralen Prishtinë - Beograd. Mënyra më e preferuar është vetura.

Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese – shkollë, qerdhe apo objekt shëndetësor. Vetëm një pjesë e lagjes përfshihet në rrezen e shërbimeve të shkollës më të afërt. Shërbimet tjera kanë larg nga lagja.

Dendësia ndërtimore është e ultë 7shtëpi/ha.

INFRASTRUKTURA

- Për shkak se shtrirja e shtëpive është e fragmentuar, në disa pjesë infrastruktura është prezente, kurse në disa pjesë ajo mungon. Shumica e shtëpive janë të lidhura në sistemin e ujësjellësit, kurse vetëm 15% janë të lidhur në kanalizim. Largimi i mbeturinave në

Vendbanimet Joformale

mënyrë të organizuar është në 45% të numrit të shtëpive, kurse 29% largimi i mbeturinave është në deponi joformale.

- Për shkak të afërsisë së rrugës e cila e lidhë qytetin me magjistralen Prishtinë – Beograd, afërsia e vijave primare të infrastrukturës mundëson që rregullimi i infrastrukturës të jetë më i lehtë.



*Pamje
lagjes “2
Korriku”*

Vendbanimet Joformale

Lagja “Mallaha e Romëve”¹

POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI

Lagja “Mahalla e Romëve” shtrihet në pjesën qendrore të qytetit. Zanafilla e saj është nga periudha e pas Luftës së Dytë Botërore. Rritja e qytetit ka bërë që kjo lagje tani të jetë pjesë e qendrës së qytetit. Për shkak se kjo lagje është shkatërruar tërësisht pas luftës në Kosovë, dhe për shkak të gjendjes së mjerueshme të banorëve të saj në pjesën veriore të qytetit, autoritetet komunale së bashku me donatorët janë duke e hartuar planin rregullues të lagjes së re sipas standardeve të cilat duhet të mundësojnë një jetë kualitative.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK¹, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuatë ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuatë ose mospjesëmarrje në qeverisje
- Rrezikshmëri deri në diskriminim.

PRONËSIA MBI TOKËN

Në kuadër të lagjes ka pronësi publike dhe private. Komuna disponon me dokumentacion kadastral për të gjithë pronarët. Janë identifikuar tri lloje të pronave:

- Pronë private - 4.1 ha me 351 ngastra
- Pronë komunale – 9.4 Ha me 219 ndërtesa
- Pronë shoqërore e menaxhuar nga AKM – 7.26 ha
- Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 20.76 Ha

MJEDISI NATYROR

- Lagja ka qenë e karakterizuar me dendësi të madhe ndërtimi. Gjendja ekzistuese e Mahallës së romëve është një shkatërrim total. Mbeturinat e rrënojave janë burim i ndotjes dhe paraqesin rrezik për kalimtarë.
- Lokacioni i lagjes është përgjatë lumit Ibër që paraqet një ambient me vlerë të posacme. Një numër i madh i ndërtimeve ilegale kanë atakuar jo vetëm bregun e lumit por edhe florën dhe faunën përgjatë bregut të lbrit.
- Problem tjetër mjedisor kanë shkaktuar derdhjet e kanalizimit në lumë.

¹ Shumica e të dhënave për “Mahallën e Romëve” janë marrë nga projekt propozimi për hartimin Planit Rregullues Urban të Këshillit Danez për Refugjatë (DCR), qershor 2004. Për databazë shënime nuk janë kompletuar ende për shkak të pamundësisë të intervistimit të banorëve në pjesën veriore të qytetit.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.

KLIMA

- Meqenëse lokacioni gjendet përgjatë bregut të lumit, klima është e volitshme për shkak se rrymimet ajrore ndikojnë pozitivisht.
- Insolimi është i volitshëm për shkak tëse terreni është i rrafshët dhe nga ana jugore është i kufizuar me një sipërfaqe të hapur me tokë bjëësore.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes është e rrafshët.

PLANIFIKIMI

Shkollat më të afërta nuk kanë siguruar mbulim të mjaftueshëm të nxënësve nga “Mahalla e Romëve”. Por, romët të cilë kanë folë gjuhën serbe janë shkolluar në veri, kurse ata që kanë ditur gjuhën shqipe janë shkolluar në pjesën jugore të qytetit.

Distanca e çerdhes, poashtu nuk ka siguruar qasje për të gjithë fëmijët e kësaj zone.

Ajo që e karakterizon këtë lokacion është afërsia e përmbajtjeve sportive – dy stadiumet dhe fushat e lojës edhepse ato janë përmbajtje për tërë qytetin.

Përmabjtjet tregtare shërbyese si ato të tregtisë së përditshme dhe shërbimve zejtare të nevojshme për lagje janë në afërsi.

“Mahalla e Romëve” është e lidhur me qytetin me dy rrugë kryesore- njëra që shkon në pjesën perëndimore dhe tjetra në atë veriore përmes urës. Rrugët brenda lokacionit janë të ngushta dhe pa asfalt dhe jo të gjitha shtëpitë kanë patur qasje në rrjetin e rrugëve. Brenda lokacionit nuk ka patur rrugë të këmbësorëve.

INFRASTRUKTURA

Edhe pse lagja ka patur furnizim me rrymë, shumica e kyçjeve kanë qenë ilegale. Infrastruktura e furnizimit me rrymë tani nuk ekziston më.

Rrjeti i furnizimit me ujë ka qenë joadekuat. Shumica e kyçjeve kanë qenë ilegale.

Vetëm një pjesë e kanalizimit ka qenë e lidhur në rrjetin formal, kurse shumica e kanë derdhur përmes gypave të hapur direkt në lumë që ka qenë një rrezik permanent për shëndetin e banorëve.

“Mahalla e Romëve” ka qenë e lidhur me rrjetin e telefonisë me 68 numra telefonik në vitin 1999. Një vijë telefonike e kryesore e përshkon lagjen.

LARGIMI I MBETURINAVE

Edhepse lagja është e shkatërruar dhe e pabanuar ajo është e përfshirë në shërbimin komunal të largimit të mbeturinave. Mirpo, mbeturinat e shtëpive të shkatërruara ende nuk janë larguar nga lokacioni.

Vendbanimet Joformale



Location and number of Roma IDPs in Kosovo as of June, 2004

Vendi dhe
numri i
romëve
sipas IDP
në Kosovë
nga
qershori
2004

Lokacioni i të zhvendosurve	# Familjarë	Persona
Kosovë	91	523
Cesmin Lug	38	205
Zitkovc	24	147
Kablar	4	10
Leposaviç	17	120
Mitrovicë –vendosje private	8	41
Serbi dhe Mal i Zi	31	196
Suboticë	9	70
Novi Sad	4	17
Mladenovc	2	7
Beograd	8	62
Smederevska Pallankë	1	6
Novi Pazar	6	27
Raska	1	7
Familjarët e identifikuar deri më tani	122	719



Lagjja – “Kroi i Vitakut”

Vendbanimet Joformale

POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI

Për shkak të pasigurisë dhe pamundësisë së shkuarjes atje, nuk ka mundur të hulumtohet lagjja “Kroi i Vitakut”.


- Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 9.16 ha

MJEDISI NATYROR

- Nga fotografitë ajrore shihet se lagjja është shkatërruar tërësisht, dhe ende nuk është mundësuar rindërtimi i asnjë shtëpie.



Rrezja e shërbimeve të infrastrukturës sociale në raport me vendbanimet joformale në qytetin e Mitrovicës



GJAKOVA

Në qytetin e Gjakovës janë hulumtuar tri vendbanimet joformale të cilat janë zgjedhur nga klasifikimi i bërë nga grupi i interesit dhe OSCE si dhe nga identifikimi i zyrtarëve komunal të cilët janë bazuar në gjendjen aktuale kadastrale dhe të planeve ekzistuese urbane. Po ashtu janë marrë parsysh edhe karakteristikat ekzistuese të vendbanimeve joformale të përshkruara nga grupi i palëve të interesit për VBJF në Qeverinë e Kosovës. Këto tri lagje janë: lagjja “Kolonia”, lagjja “Brekoci” dhe lagjja “Piskota (Dardania)”.

Ndonëse shumica e vendbanime joformale në Kosovë nuk karakterizohen me jositurinë e pronës, në vendbanimet e hulumtuara në Gjakovë, ekzistojnë raste të papërcaktuara të pronësisë, ku shfrytëzuesit nuk janë në posedim të pronës, si dhe numër i vogël i uzurpimeve të cilat janë në proces të zgjidhjes.

Ajo që i karakterizon vendbanimet joformale në Gjakovë janë:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë
- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje

Mungesa e shërbimeve elementare të infrastrukturës teknike dhe sociale është treguar të jetë arsyeja kryesore për pjesëmarrje joadekuate.

Që të tri lagjet janë kryesisht të banuara me komunitetin RAE mbi 70% (romë, ashkalinj, dhe egjiptas), kurse ai shqiptar në 30 %.

Infrastruktura fizike në këto tri lagje edhe pse ekziston (uji, rryma, kanalizimi dhe grumbullimi i mbeturinave), ajo është joadekuate. Posaçërisht rrugët, transporti urban (me përjashtim “Piskota” (Dardania) dhe hapësirat publike janë ato të cilat e vështirësojnë gjendjen.

Arsimi fillor dhe parashkollor paraqet problem të madh në tërë qytetin për shkak se hapësirat janë të pamjaftueshme. Mirëpo, në të tri këto lagje, shërbimet themelore nuk janë edhe aq në afërsi (me përjashtim të lagjes “Kolonia” sepse shkolla gjendet mu në lagje për arsim fillor dhe atë parashkollor).

Nr.	Vendbanimi / emërtimi	Urgjenca			Plani që e rregullon			Madhësia			Konteksti urban/rural		
		ASH / AM / AGJ			PZHK / PZHU / PRRU			v / m / M			U / UR / R		
1	Kolonia	X				X				X	X		
2	Brekoci	X				X				X	X		
3	Dardania	X				X		X			X		

ASH - Afat shkurtë AM - Afat mesëm AGJ - Afat gjatë

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
PZHU - Plani Zhvillimor Urban
PRRU – Plani Rregullues Urban

v - I vogël
m - I mesëm
M - I madhë

U - Urban
UR - Urban Rural
R - Rural

Për shkak të ngarkesës me punë të Drejtorisë së Kadastrit, përpilimi i evidencës pronësore në kuadër të VBJF (fletë poseduese dhe kopje e planit) nga Drejtorati i Urbanizmit nuk ka qenë e mundur të kryhet.


Autoritetet komunale kanë filluar procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal. Ky proces mund të shfrytëzohet edhe për fokusimin në rregullimin e vendbanimeve joformale në të cilat janë të shprehura problemet themelore të infrastrukturës dhe shërbimeve tjera siç janë arsimi parashkollor dhe fillor e poashtu edhe ai ambulantor.

Të gjithë indikatorët tregojnë për një gjendje të vështirë sociale dhe ekonomike. Punësimi i kohëpaskohshëm (varësisht se si gjejnë punë) dominon në të ardhurat financiare. Përqindja e atyre që janë të punësuar është shumë e vogël dhe po ashtu ekzistojnë shumë pak familje që kanë burime financiare nga jashtë. Në anën tjetër punësimi jashtëzakonisht i vogël i gjinisë femërore, që lidhet me niveli e ulët arsimor, paraqesin rrethana të vështira për sigurimin e ekzistencës.

Niveli i ulët arsimor (2 % student dhe 2 % me shkollim të lartë), është indikator i rëndësishëm i cili ndikon në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik si dhe në shkallën e papunësisë dhe varfërisë.

Dominimi i familjeve të mëdha dhe të zgjeruara, tregon gjithashtu shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik, ku në pjesën më të madhe të familjeve që kanë anëtar të punësuar, është vetëm një mbajtës i familjes, ndërsa femra ka mbetur pothuaj se tërësisht jashtë tregut të punës.

Gjendja e banimit paraqitet si shumë e vështirë dhe kjo tregohet nga përgjigjet që janë marrë sa i përket kësaj çështjeje.



13 % - e mirë
28 % - mesatare
42 % - e dobët
6 % - e papreferueshme
6 % - e shkatërruar

Rreth gjysma e familjeve tregojnë se gjendja e banimit është e dobët, e pa preferueshme apo edhe e shkatërruar. Sa i përket kushteve të banimit 80 % e shtëpive kanë kushte të banueshme, por bëhet fjalë për kushte të dobëta banimi, ndërsa 20 % e shtëpive nuk

kanë kushte për banim. Sa i përket vjetërsisë së shtëpive të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i shtëpive janë ndërtuar pas vitit 1999 (37 %), dhe shtëpitë në këtë vendbanim kanë filluar të ndërtohen në vitet e 60' dhe të 70'-ta.



Pozita e vendbanimeve joformale në kuadër të qytetit të Gjakovës

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor – Insituti për Planifikim Hapësinor

Lagja – “Kolonia”, Gjakovë**POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI**

Lagja “Kolonia” shtrihet në pjesën lindore në hyrje të qytetit. Vjetërsia e kësaj lagjeje ka zanafillën para 30 vjet. Aktualisht me planet komunale kjo zonë është tokë bujqësore dhe se mosrespektimi i planeve urbane ka bërë që shërbimet themelore të mos jenë në nivelin e kënaqshëm. Popullata në këtë lagje është e kombinuar: me koncentrim të konsiderueshëm prej 80 % RAE (romë, ashkalinj dhe egjiptas) dhe 20 % shqiptarë. Sipërfaqja e territorit të identifikuar cca 10.61 ha.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë në më se 40 % (joposedim dhe uzurpim)
- Qasje joadekuate në shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate sa duhet në qeverisje

PRONËSIA MBI TOKËN

Në kuadër të lagjes ka pronësi të kombinuar - publike dhe private. Dokumentacioni kadastral ekziston në Drejtorinë për Kadastër dhe disa prej pronarëve i kanë fletat poseduese (katër prej tyre). Mbi 25 % e rasteve janë pronë e joposeduar, kurse 15 % janë raste të uzurpimit të lokacioneve në hapësirën e këtij territori.

- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Gjakovës është në fazën e përgatitjes të Planit Zhvillimor Urban dhe atij Rregullues.



Vendbanimet Joformale

MJEDISI NATYROR

- Lagjja karakterizohet me ndotje të ajrit sepse ndodhet shumë afër deponia komunale e mbeturinave dhe me dendësi të madhe ndërtimi.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Infrastruktura fizike është prezente dhe formale (rryma, uji, kanalizimi dhe largimi i mbeturinave; përveç telefonisë fikse dhe internetit); kurse nga ajo sociale është e pranishme shkolla me arsim fillor dhe parashkollor në vetë lagjen mirëpo shërbimi shëndetësor pak më larg.



KLIMA

- Për shkak të vendndodhjes së vendbanimit vijnë në pah erërat të cilat mund të kenë ndikim.
- Insolimi është i shumë i volitshëm për shkak të ndërtimeve të ulëta dhe se lokacioni është i rrafshët.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes është i rrafshët mbi bregore që mundëson kullim të shpejtë.

NDIKIMI NË MJEDIS

- Afërsia e deponisë komunale, shkakton ndotje të ajrit.
- Pë shkak të afërsisë së deponisë komunale, shtëpitë të cilat furnizohem me ujë nga pusi, janë të ndikuar në kualitetin e ujit për pije.
- Reduktimi i ndotjes së ajrit arrihet vetëm me largimin e kësaj deponie.

PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësirat e lira të mjaftueshme për lojë fëmijësh dhe shfrytëzimi tyre për qëllime afariste (grumbullimi materialeve të recikluara nga deponia) si dhe sipërfaqet e dedikuara për rrugë. Mungojnë hapësirat e gjelbërta dhe ato për rekreacion.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë mjaft të gjëra mirëpo jo të asfaltuara. Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik nuk është në distancë të madhe mirëpo edhe shërbimet e taksive mundësojnë qasje për të gjithë dhe në çdo anë.
- Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese – objekt shëndetësor, kurse shkolla me çerdhe (përmbajtje të arsimit fillor dhe parashkollor) janë në vetë lagjen -e posandërtuar, dhe mund të konsiderohet se arsimit, shëndetsia, puna, tregtia
- Densiteti-numri i shtëpive për hektar, sipërfaqja e ndërtuar për hektar – mesatarisht 10 shtëpi / ha ose 10 ari / shtëpi

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është relativisht e mirë mundëson furnizimin me ujë në të gjitha objektet si dhe mundëson lidhje e këtyre objekteve me kanalizimin e qytetit. Zona është e furnizuar mirë me energji elektrike, një kabinë telefonike fikse e vendosur nga PTT-ja dhe grumbullimi i mbeturinave bëhet nga shërbimet komunale.
- Rrugët janë të paasfaltuara dhe të pandriçuara.

Vendbanimet Joformale

Lagja –“Brekoci”, Gjakovë

POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI

Lagja “Brekoci” shtrihet në pjesën perëndimore në hyrje të qytetit. Vjetërsia e kësaj lagjeje ka zanafillën para më se 15 vjete. Aktualisht me planet komunale kjo zonë është zonë gjelbërimi dhe se mosrespektimi i planeve urbane ka bërë që shërbimet themelore të mos jenë në nivelin e kënaqshëm. Popullata në këtë lagje me përafërsisht 600 banorë është e kombinuar: me koncentrim të konsiderueshëm prej 75 % RAE (romë, ashkalinj dhe egjiptas) dhe 25 % shqiptarë. Sipërfaqja e territorit të identifikuar cca 12.12 ha.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë në më se 15 % (joposedim dhe uzurpim).
- Qasje joadekuatë në shërbimet elementare.
- Pjesëmarrje joadekuatë sa duhet në qeverisje.

PRONËSIA MBI TOKËN

Në kuadër të lagjes ka pronësi të kombinuar - publike dhe private. Dokumentacioni kadastral ekziston në Drejtorinë për Kadastër dhe disa prej pronarëve (gjashtëmbëdhjetë prej tyre) i kanë fletat poseduese, 27 raste kanë fletëpagesa tatimi në pronë, 2 raste me kontrata mbi shit-blerjen e pronës dhe një me faturë të energjisë. Mbi 10 % e rasteve janë pronë e joposeduar, kurse 5 % janë raste të uzurpimit të lokacioneve në hapësirën e këtij territori.

- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Gjakovës është në fazën e përgatitjes të Planit Zhvillimor Urban dhe atij Rregullues.



MJEDISI NATYROR

- Lagjja karakterizohet me: një pjesë e saj me ndotje të ajrit dhe zhurmës sepse ndodhet shumë afër separacionit “Dukagjini” SHA për ndërtime dhe ato që gjenden përkaj rrugëve komunale, kurse pjesa tjetër e qetë dhe me gjelbërim dhe me dendësi jo të madhe ndërtimi, kurse mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i saj shkakton probleme të mjedisit.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Infrastruktura nuk është e ndikuar nga kushtet gjeologjike.

KLIMA

- Për shkak të vendndodhjes së vendbanimit (luginë lumore) vijnë në pah erërat të cilat mund të kenë ndikim.
- Insolimi është i shumë i volitshëm për shkak të ndërtimeve të ulëta dhe se lokacioni është kryesisht i rrafshët.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes është me karakteristika topografike të pandryshueshme. Terreni është kryesisht i rrafshët.

NDIKIMI NË MJEDIS

Afërsia e separacionit “Dukagjini”, shkakton ndotje të ajrit dhe zhurmës e njehta momentalisht nuk punon. Ndikimi në mjedis mund të vijë nga vërshimet e rrugëve pasi që mungon kanalizimi atmosferik. Ndikim jo i vogël vjen edhe nga numri i madh i automjeteve të cilët qarkullojnë nëpër rrugët e ngushta. Mungesa e kanalizimit në disa shtëpi, poashtu mund të shkaktojë ndikim negativ në mjedis dhe ujë në puse.

PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual duke shfrytëzuar hapësira për afarizëm (tregti, prodhim,deponi, servise etj) dhe hapësirat dhe sipërfaqet e dedikuara për rrugë. Mungojnë hapësirat e gjelbërta dhe ato për rekreacion.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë mjaft të gjëra mirëpo jo të asfaltuara përveç atyre tranzite nëpër lagje. Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik është në distancë të madhe mirëpo edhe shërbimet e taksive mundësojnë qasje për të gjithë dhe në çdo anë.
- Lagjja nuk posedon përmbajtje shërbyese – objekt shëndetësor dhe shkollor, mund të

Vendbanimet Joformale

konsiderohet se arsimi, shëndetësia, puna, tregtia janë pak si të shmangura.

- Densiteti-numri i shtëpive për hektar, sipërfaqja e ndërtuar për hektar – mesatarisht 11 shtëpi / ha ose 9 ari / shtëpi.

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura fizike është prezente dhe formale (rryma dhe uji) në tërë lokacionin nga shërbimet komunale, kanalizimi dhe largimi i mbeturinave të grumbulluara në konteinerë janë të organizuara vetëm në disa pjesë – kurse pjesa më e madhe jo.
- Rrugët janë të paasfaltuara dhe të pandriçuara.
- Telefoni fikse 3 kanë deklaruar katër (4) raste.
- Mungojnë shërbimet shëndetësore, arsimore, post telegrafike, sportive dhe rekreative në vetë lokalitetin apo në afërsi.

Lagja –“Piskota” (Dardania) , Gjakovë**POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI**

Lagja “Dardania” shtrihet në pjesën veriore në hyrje të qytetit, pranë fabrikës së tjegullave. Vjetërsia e kësaj lagjeje ka zanafillën para 20 vjetëve. Aktualisht me planet komunale kjo zonë është zonë industriale dhe se mosrespektimi i planeve urbane ka bërë që shërbimet themelore të mos jenë në nivelin e kënaqshëm. Popullata në këtë lagje me përafërsisht 30 banorë është e kombinuar : me koncentrim të konsiderueshëm prej 70 % RAE (Rom dhe Ashkalinjë) dhe 30 % shqiptarë. Sipërfaqja e territorit të identifikuar cca 1.18 ha.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë në 20 % (joposedim dhe uzurpim)
- Qasje joadekuate në shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate sa duhet në qeverisje

PRONËSIA MBI TOKËN

Në kuadër të lagjes ka pronësi të kombinuar -publike dhe private. Dokumentacioni kadastral ekziston në Drejtorinë për Kadastër dhe disa prej pronarëve i kanë fletat poseduese (një prej tyre) kurse një ka kontratë shit-blerjeje dhe një fletëpagesë mbi tatimin në pronë. Mbi 20 % e rasteve janë pronë e joposeduar.

- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Gjakovës është në fazën e përgatitjes të planit zhvillimor urban dhe atij rregullues.

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me rrezikimin nga vërshimi i lumit Krena sepse lokacioni ndodhet mu përkaj lumit pa ndonjë disnivel të konsiderueshëm dhe pa ndonjë mbrojtje tjetër nga ky vërshim,
- Deridiku ndotje të ajrit sepse ndodhet shumë afër fabrikes së tjegullave.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Infrastruktura nuk është e ndikuar nga kushtet gjeologjike.

KLIMA

- Për shkak të vendndodhjes së vendbanimit dhe për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi. Kjo është posaçërisht e shprehur pasi që një pjesë e lagjes shtrihet përgjatë luginës së lumit i cili i mbledhë ujërat atmosferik.

Vendbanimet Joformale

- Insolimi është i shumë i volitshëm për shkak të ndërtimeve të ulëta dhe dendësisë së vogël të banimit kurse lokacioni është i rrafshët dhe me gjelbërim përkaj bregut lumit.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes është kryesisht e rrafshët me ndonjë ndryshim të vogël diku- diku deri në 3-4 metra.

NDIKIMI NË MJEDIS

- Afërsia e fabrikës së tjegullave, shkakton ndotje të ajrit.
- Pë shkak të afërsisë së lumit, pa disnivel të mjaftueshëm shtëpitë të cilat furnizohem me ujë nga pusi, janë të ndikuar në kualitetin e ujit për pije.
- Reduktimi i ndotjes së ajrit arrihet vetëm me filtrimin e tymit të oxhakëve prej furrave për pjekjen e dheut.


PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësirat e lira të mjaftueshme për lojë fëmijësh si dhe sipërfaqet e dedikuara për rrugë.
- Mungojnë hapësirat për rekreacion.
- Trafiku vetanak automobilistik nëpër rrugë të ngushta sepse lokacioni është i vogël. Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Transporti publik nuk është në distancë të madhe mirëpo edhe shërbimet e taksive mundësojnë qasje për të gjithë dhe në çdo anë.
- Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese—objekt shëndetësor, kurse shkolla me çerdhe (përmbajtje të arsimit fillor dhe parashkollor) janë në vetë lagjen -e posandërtuar, dhe mund të konsiderohet se arsimi, shëndetësia, puna, tregtia janë në shërbim të lagjes.
- Densiteti-numri i shtëpive për hektar, sipërfaqja e ndërtuar për hektar – mesatarisht 7 shtëpi / ha ose 15 ari / shtëpi.

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura fizike është prezente dhe formale nga shërbimet komunale (rryma, uji); kanalizimit i cili derdhet drejt e në lumin e cekur, përveç largimit të mbeturinave, telefonisë fikse dhe internetit në të cilat; kurse nga ajo sociale shërbimet shëndetësore mund të bëhen në afërsi prej 100 metrash (tek qendra e mjekësisë së punës –dispanzeri pranë ish-industrisë tekstile IBT “Emin Duraku”, kurse shërbimet arsimore janë pak më largë në shkollën e lagjes “Dardania” arsimi fillor dhe ai parashkollor jo larg afërsisht 200 metra pranë industrisë tekstile dhe trikotazhi “Përparimi”-ish “Napredaku”.
- Rrugët janë të paasfaltuara dhe të pandriçuara.

Vendbanimet Joformale



Rrezja e shërbimeve të infrastrukturës sociale në raport me vendbanimet joformale në qytetin e Gjakovës

Vendbanimet Joformale

GJILANI

Në qytetin e Gjilanit janë hulumtuar tri vendbanimet joformale të cilat janë zgjedhur nga klasifikimi i bërë nga grupi i interesit dhe OSCE si dhe nga identifikimi i zyrtarëve komunal të cilët janë bazuar në gjendjen aktuale kadastrale dhe të planeve ekzistuese urbane. Po ashtu janë marrë parasysh edhe karakteristikat ekzistuese të vendbanimeve joformale të përshkruara nga grupi i palëve të interesit për VBJF në Qeverinë e Kosovës. Këto tri lagje janë: lagja “Abdullah Presheva”, rruga “Marie Shllaku”, dhe lagja “Zabeli i Sahit Agës”.

Ndonëse shumica e vendbanime joformale në Kosovë nuk karakterizohen me josigurinë e pronës, në vendbanimet e hulumtuara në Gjilan, ekzistojnë raste të papërcaktuara të pronësisë, ku shfrytëzuesit nuk janë në posedim të pronës, si dhe numër i vogël i uzurpimeve të cilat janë në proces të zgjidhjes.

Ajo që i karakterizon vendbanimet joformale në Gjilan janë:

- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje

Mungesa e shërbimeve është treguar të jetë arsyeja kryesore për pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje. Kur autoritetet nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbimet elementare të infrastrukturës teknike dhe sociale, banorët e humbin interesin të marrin pjesë në qeverisje.

Dy lagjet e para janë kryesisht të banuara me komunitetin rom dhe ato për shkak të vjetërsisë së tyre tanimë janë në pjesën qendrore të qytetit. Infrastruktura fizike në këto dy lagje edhe pse ekziston, ajo është joadekuate. Posaçërisht rrugët dhe hapësirat publike janë ato të cilat e vështirësojnë gjendjen.

Arsimi fillor dhe parashkollor paraqet problem të madh në tërë qytetin për shkak se hapësirat janë të pamjaftueshme. Mirëpo, në të dy këto lagje, shërbimet themelore janë në afërsi. Shkolla dhe objekti shëndetësor janë në afërsi, kurse arsimi parashkollor është në distancë shumë të madhe.

Lagja “Zabeli i Sahit Agës” është e banuar kryesisht me shqiptarë. Lokacioni i saj është në periferi dhe ndërtimi i shtëpive është bërë në mënyrë të shpërndarë dhe me dendësi të vogël gjë që ndikon në vështirësimin e ofrimit të infrastrukturës. Sa i përket shërbimeve themelore, në këtë lagje nuk ka asnjë shërbim i cili mund ta karakterizojë vendbanimin si urban. Lidhjet me qytetin janë të kufizuara vetëm në transportin individual me automjete vetanake si dhe me shërbimin taksist i cili është efikas.

Nr.	Vendbanimi / emërtimi	Urgjenca			Plani që e rregullon			Madhësia			Konteksti urban/rural		
		ASH / AM / AGJ			PZHK / PZHU / PRRU			v / m / M			U / UR / R		
1	Rr.Avdullah Presheva	X					X	X			X		
2	Rr.Marie Shllaku	X					X	X			X		
3	Zabeli i Sahit Agës	X					Pjesërisht			X		X	

ASH - Afat shkurtë AM - Afat mesëm AGJ - Afat gjatë

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal PZHU - Plani Zhvillimor Urban PRRU - Plani Rregullues Urban

v - I vogël m - I mesëm M - I madhë

U - Urban UR - Urban Rural R - Rural

Për shkak të ngarkesës me punë të Drejtorisë së Kadastrit, përpilimi i evidencës pronësore në kuadër të VBJF (fletë poseduese dhe kopje e planit) nga Drejtorati i Urbanizmit nuk ka qenë e mundur të kryhet.

Autoritetet komunale kanë filluar procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal. Ky proces mund të shfrytëzohet edhe për fokusimin në rregullimin e vendbanimeve joformale në të cilat janë të shprehura problemet themelore të infrastrukturës dhe shërbimeve tjera siç janë arsimi parashkollor dhe shkollor.

Problemet lidhur me pronën në komunën e Gilanit janë në zgjidhje e sipër. Ky proces do të marrë ende një kohë për shkak të mungesës së informatave të marra nga pushteti serb si dhe për shkak të mungesës së rregulloreve ligjore përkatëse. Problemet e shërbimeve themelore janë të shprehura jo vetëm në vendbanimet joformale, por edhe në tërë qytetin. Kanalizimi dhe furnizimi me ujë të pijes, si problemet më të mëdha në qytet duhet të adresohen me Planin Zhvillimor Urban. Po ashtu sigurimi i infrastrukturës sociale duhet të jetë në fokus të planit, për të krijuar bazën e fillimit të rregullimit të lagjeve.

Gjendja socioekonomike - Indikatorët nga hulumtimi në Gjiilan tregojnë për një gjendje pak më të mirë sociale dhe ekonomike edhe pse shumica e të intervistuarve nuk janë përgjigjur në pyetjet që janë me rëndësi për të paraqitur gjendjen socio-ekonomike. Nga përgjegjjet e marra tregohet se rreth gjysma e familjeve kanë të punësuar ndonjë anëtar të familjes, por një pjesë tjetër e konsiderueshme e familjeve janë me ndihma sociale dhe nuk kanë fare të ardhura që do të thotë se edhe këtu kemi numër të konsiderueshëm të familjeve që kanë varfëri të skajshme. Papunësia edhe pse në masë më të vogël, poashtu është e shprehur. Rreth gjysma e familjeve nuk kanë të punësuar asnjë anëtar, por edhe ato familje që kanë të punësuar, nuk i kanë të punësuar të gjithë anëtarët që janë të aftë për punë (popullsi aktive). Rreth 55 % e popullsisë konsiderohet si popullsi aktive që janë të moshës 18-65 vjeç, dhe nga tërë kjo fuqi punëtore del shkallë e lartë e të pa punëve.

Niveli i ulët arsimor (3 % student dhe 6 % me shkollim të lartë), është indikator i rëndësishëm i cili ndikon në nivelin e ulët të zhvillimit social dhe ekonomik, por në anën tjetër, pjesa më e madhe e popullsisë e ka të kryer shkollën fillore dhe të mesme, dhe kjo mund të ketë ndikim pozitiv. Por, duhet kushtuar vëmendje e posaçme pjesës tjetër (27 %) e cila nuk e ka të kryer nivelin fillor të shkollimit.

Gjendja e banimit është më e mirë se në tri qytetet tjera. Kjo tregohet nga përgjigjet që janë marrë nga terreni për këtë çështje.

- 46 % -e mirë
- 17 % -mesatare
- 11 % -e dobët
- 22 % -e papreferueshme
- 4 % - e shkatrruar

Rreth gjysma e rasteve tregojnë se gjendja e banimit është e mirë.

Sa i përket kushteve të banimit 66 % e shtëpive kanë kushte të banueshme, ndërsa 30 % e shtëpive nuk kanë kushte për banim, përderisa rreth 5 % nuk kanë dhënë përgjegje.

Vendbanimet Joformale



Pozita e vendbanimeve joformale në kuadër të qytetit të Gjilanit

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
Departamenti i Planifikimit Hapësinor – Insituti për Planifikim Hapësinor

Lagja – Rruga “Avdullah Presheva”**POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI**

Lagja “Rruga Adullah Presheva” shtrihet në pjesën veriore të qytetit. Kjo zonë ka ekzistuar si pjesë e qytetit qysh para 90 viteve (vjetërsia e vendbanimit-90 vjet). Është zonë në të cilën ekziston Plani Rregullativ Urban (Plani Detal Urbanistik). Në këtë lagje kemi një koncentrim të konsidrueshëm të pjestarëve të komunitetit rom. Mosrespektimi i Planit Rregullues Urban ka bërë që niveli i shërbimeve themelore të mos jetë në nivelin e kënaqshëm.

Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 1,7 ha

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë në (34% - raste të joposedimit dhe uzurpimit)
- Qasje joadekuate në shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje



Pamje e një rruge ne lagjen “Avdullah Presheva”

PRONËSIA MBI TOKËN

- Posedimi i pronës në këtë zonë është kryesisht privat. Dokumentacioni kadastral ekziston në Drejtorinë e Kadastrit dhe pjesa dërmuese e pronarëve i kanë fletat poseduese, edhe pse vetëm njëri nga të intervistuarit e ka treguar fletën poseduese dhe dy kanë patur leje të shfrytëzimit nga DÇBP. Mbi 26% të rasteve janë pronë jo e poseduar, kurse 8% janë raste uzurpimi në tërë lokacionin.
- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Gjilanit është në fazën përgaditore të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban.

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të madhe ndërtimi (cca 64 shtëpi/ha- mesatarisht 1.5 ari/shtëpi), me objekte të ndërtuara në formë të pakontrolluar, me lartësi të ndryshme, me destinim shfrytëzimi privat dhe afarist. Në lagje janë 10 lokale afariste të cilat ofrojnë disa shërbime tregtare dhe hoteliere.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Infrastruktura nuk është e ndikuar nga kushtet gjeologjike.

KLIMA

- Përshkak të dendësisë së madhe të shtëpive, insolimi nuk është i volitshëm.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes “Rruga Avdullah Presheva” është me karakteristika topografike kryesisht të pandryshueshme. Terreni është kryesisht i rrafshët, ka një pjerrtësi shumë të vogël në kuadër të lokacionit të vetë lagjes.

NDIKIMI NË MJEDIS

- Ndikimi në mjedis mund të vije nga vërshimet e rrugëve pasi që mungon kanalizimi atmosferik.
- Ndikim jo i vogël vjen edhe nga numri i madh i automjeteve të cilat qarkullojnë nëpër rrugët e ngushta.
- Mungesa e kanalizimit në disa shtëpi, poashtu mund të shkaktojë ndikim negativ në mjedis.

PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është banimi individual duke shfrytëzuar hapësirat e përdhësës në objekte për qëllime afariste dhe hapësirat e dedikuara për rrugë janë të pamjaftueshme për funksionim të mirë të qarkullimit në kuadër të lagjes.

- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate. Hapësirat e ndara për këmbësorë janë shumë të ngushta ose nuk ekzistojnë fare dhe nuk ekzistojnë hapësira për parking si dhe mungojnë hapësirat e gjelbërta dhe rekreative në lagje.
- Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese –shkollë, çerdhe apo objekt shëndetësor. Mirpo, këto përmbajtje nuk janë në largësi të madhe, ndërsa çerdhe të fëmijëve nuk ka as në lagjet fqinje.
- Lagja karakterizohet me dendësi të madhe ndërtimi (cca 64 shtëpi/ha- mesatarisht 1.5 ari/shtëpi)

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është relativisht e mirë mundëson furnizimin me ujë në të gjitha objektet si dhe mundëson lidhjen e këtyre objekteve me kanalizimin e qytetit. Zona është e furnizuar me energji elektrike dhe grumbullimi i mbeturinave bëhet nga shërbimet komunale.
- Rindërtimi i objekteve të banimit (ARC) dhe rregullimi i infrastrukturës (Komuna) janë projekte të cilat janë në zbatim duke tentuar që të ngrisin nivelin e kualitetit të jetës në këtë lagje.
- Banorëve të kësaj lagjeje është duke ju ofruar edhe asistencë ligjore nga zyra ligjore e komunës dhe zyra e juristëve nga ARC-së. Gjithashtu përfaqësimi i interesave të banorëve të kësaj lagjeje bëhet përmes përfaqësuesit i cili është i përkatësisë rome dhe i zgjedhur nga vetë komuniteti i lagjes.



Pamje e një rruge në lagjen "Abdullah Presheva"

Vendbanimet Joformale

Rruga – “Marie Shllaku” – Stacioni i Autobusëve

POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI

Lagja “Pjesa nën stacion të autobusëve” shtrihet në pjesën qendrore të qytetit, përkatësisht nën pjesën e poshtme të Stacionit të Autobusëve. Kjo zonë ka ekzistuar si pjesë e qytetit qysh para 90 viteve (vjetërsia e vendbanimit-90 vjet). Është zonë në të cilën ekziston Plani Rregullues Urban (Plani Detal Urbanistik). Në këtë lagje kemi një koncentrim të konsiderueshëm të pjestarëve të komunitetit rom. Mosrespektimi i Planit Rregullativ Urban ka bërë që niveli i shërbimeve themelore të mos jetë në nivelin e kënaqshëm.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë –vetëm në 9% të rasteve
- Qasje joadekuate në shërbimet elementare – kryesisht infrastruktura rrugore dhe kanalizimi
- Pjesëmarrje joadekuate në qeverisje

PRONËSIA MBI TOKËN

Posedimi i pronës në këtë zonë është kryesisht privat. Dokumentacioni kadastral ekziston në Drejtorinë e Kadastrit dhe pjesa dërmuese e pronarëve i kanë fletat poseduese, edhe pse vetëm tre nga të intervistuarit e kanë treguar fletën poseduese. Afër 9% të rasteve janë pronë jo e poseduar, kurse raste uzurpimi nuk ka në lokacion.

Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 0.93ha

- Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Gjilanit është në fazën përgaditore të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban.

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të madhe ndërtimi, (cca 62 shtëpi/ha- mesatarisht 1.66 ari/shtëpi) me objekte të ndërtuara në formë të pakontrolluar, me lartësi të ndryshme, me destinim shfrytëzimi privat dhe afarist.

KUSHTET GJEOLOGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive ndryshon nga ato të ndërtuara shumë dobët, deri të ato të cilat i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.
- Infrastruktura nuk është e ndikuar nga kushtet gjeologjike.

KLIMA

- Për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi. Kjo është posaçërisht e shprehur pasi që një pjesë e lagjes shtrihet përgjatë luginës e cila i mbledhë ujërat atmosferike.
- Përshkak të dendësisë së madhe të shtëpive, insolimi nuk është i volitshëm.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes “Marie Shllaku” (pjesa nën Stacion të Autobusëve) është me karakteristika topografike kryesisht të pandryshueshme. Terreni është kryesisht i rrafshët, ka një pjerrtësi shumë të vogël në kuadër të vetë lagjes.



Pamje e rrugës “Marie Shllaku”

NDIKIMI NË MJEDIS

- Afërsia e stacionit të autobusëve ndikon në ndotjen e ajrit nga qarkullimi i automjeteve – pluhuri dhe tymi.

PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është banimi individual, kurse në disa raste duke shfrytëzuar hapësirat e përdhësës për qëllime afariste dhe hapësirat e dedikuara për rrugë janë të pamjaftueshme për funksionim të mirë të qarkullimit në kuadër të lagjes.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate. Hapësirat e ndara për këmbësorë janë shumë të ngushta dhe nuk ekzistojnë hapësira për parking si dhe mungojnë hapësirat e gjelbërta dhe rekreative në lagje.
- Përmbajtjet shërbyese – shkollë, çerdhe apo objekt shëndetësor. Këto përmbajtje janë në afërsi dhe mund të konsiderohet se arsimi, shëndetësia, puna, tregtia janë në shërbim të lagjes
- Densiteti-numri i shtëpive për hektarë është 62/ha - mesatarisht 1.66 ari/shtëpi

INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është relativisht e mirë mundëson furnizimin me ujë në të gjitha objektet si dhe mundëson lidhje e këtyre objekteve me kanalizimin e qytetit. Zona është e furnizuar me energji elektrike dhe grumbullimi i mbeturinave bëhet nga shërbimet komunale.
- Rregullimi i infrastrukturës në këtë pjesë nga komuna, është një projekt në zbatim duke tentuar që të ngris nivelin e kualitetit të jetës në këtë lagje.
- Banorëve të kësaj lagjeje është duke ju ofruar edhe asistencë ligjore nga zyra ligjore e komunës. Gjithashtu përfaqësimi i interesave të banorëve të kësaj lagjeje bëhet përmes përfaqësuesit i cili është i përkatësisë romë dhe i zgjedhur nga vetë komuniteti i lagjes.



Pamje e rrugës “Marie Shllaku”

Lagja “Zabeli i Sahit Agës”

POZITA E LAGJES DHE KLASIFIKIMI

“Zabeli i Sahit Agës” shtrihet në pjesën jug-lindore të qytetit. Kjo zonë ka pasur një Plan Rregullativ Urban të pjesërishtëm (Plan Detal Urbanistik) por në një sipërfaqe të konsiderueshme i cili tanimë nuk ekziston. Me rritjen e numrit të poullësisë dhe vendosjen e tyre në pjesën jug-lindore para 30 vjetëve ka filluar edhe formimi i këtij vendbanimi. Vendbanimi është kryesisht në vitet 90 kur qeveria lokale nuk ka punuar asgjë në lidhje me zhvillimin e qytetit.

Sipas kriterëve të përshkruara nga PZSK, në lagje janë të shprehura këto karakteristika:

- Qasje joadekuate në shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate në qeverisje

PRONËSIA MBI TOKËN

Posedimi i pronës është privat në pjesën dërmuese të vendbanimit, por pjesërisht ka edhe uzurpim të pronës publike dhe shoqërore. Dokumentacioni kadastral ekziston në institucione dhe pjesa dërmuese e pronarëve i kanë fletat poseduese.

Sipërfaqja e territorit të identifikuar, cca 95.6 ha

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim i Komunës së Gjilanit është në fazën përgaditore të planit zhvillimor urban.

MJEDISI NATYROR

- Lagja karakterizohet me dendësi të vogël të ndërtimi, kurse mungesa e infrastrukturës dhe mosfunksionimi i saj shkakton probleme të mjedisit, mirëpo problem shumë i madh është kanalizimi i parregulluar i cili paraqet edhe rrezik për shëndetin jo vetëm të banorëve të këtij vendbanimi por për tërë qytetin.

KUSHTET GJEOLGJIKE DHE TOKA

- Kushtet gjeologjike të terrenit nuk kanë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e lagjes. Ndërtimi është kryesisht i ulët, dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimin e mëtejshëm në lagje.
- Ndërtimi i shtëpive në këtë lagje kryesisht i respekton standardet e ndërtimit sa i përket stabilitetit të ndërtesave. Shumica e shtëpive janë të reja dhe të ndërtuara me materiale kualitative.
- Për ndërtimin e infrastrukturës, kushtet gjeologjike nuk paraqesin ndonjë problem.

KLIMA

- Për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës, të reshurat e furishme shumë shpesh shkaktojnë probleme nga vërshimi.
- Meqenëse një pjesë e lokacionit është e kthyer nga veri-perëndimi, ndikimi i erërave është më i shprehur, për shkak se në Gjilan erërat më të shpeshta janë ato veriore.
- Insolimi në pjesën tjetër të lagjes është i volitshëm për shkak të orientimit jugor si dhe dendësisë jo të madhe të ndërtimit në momentin e tanishëm.

TOPOGRAFIA

- Topografia e lokacionit të lagjes “Zabeli i Sahit Agës” është dinamike me një ndryshim jo të theksuar të lartësisë. Terreni i pjerrtë nuk ndikon shumë në lëvizjen e qytetarëve të kësaj lagje, por duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës rrugore dhe mungesën e transportit publik, lëvizja është e kufizuar.



Pamje e një rruge në lagjen “Zabeli i Sahit Agës”

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

- Ndikimet në biodiversitetin e lokacionit dhe përreth lagjes janë të vogla, për shkak të dendësisë së vogël ndërtimore
- Problemet kryesore të mjedisit vijnë kryesisht nga mungesa e kanalizimit si dhe nga derdhja joadekuate e kanalizimit të qytetit i cili është i papërfunduar. Ky ndikim është i shprehur në të tri aspekte – në ajër, tokë dhe ujin e pijes. Edhe pse këto dy të fundit janë pak të ndikuara për shkak se lokacioni shtrihet në bregore dhe rrjedhja e ujërave është kah pjesa e rrafshët, por gropat septike joadekuate me siguri në periudha më të gjata do të ndikojnë në ndotjen e ujit të pijes nëpër puse.

PLANIFIKIMI

- Destinimi i sipërfaqeve në lagje është kryesisht banimi individual dhe hapësirat e dedikuara për rrugë janë shumë të ngushta.
- Trafiku dhe transporti zhvillohet nëpër rrugë të ngushta dhe joadekuate, vetëm rruga e cila e përshkon vendbanimin është e asfaltuar, ndërsa rrugët të cilat degëzohen nëpër vendbanim janë të paasfaltuara. Nuk ekzistojnë hapësira të ndara për këmbësorë. Megjithatë ekziston shërbimi taksist i cili është efikas, mungesa e transportit publik

vështirëson zhvillimin e kësaj lagjeje gjë që ndikon në uljen e kualitetit të jetës të banorëve.

- Lagja nuk posedon përmbajtje shërbyese – shkollë, çerdhe apo objekt shëndetësor. Këto përmbajtje janë në largësi shumë të madhe dhe kjo bënë që shfrytëzimi i këtyre shërbimeve themelore të jetë i vështirësuar.
- Densiteti në këtë lagje është shumë i vogël – 4.35 shtëpi për hektarë.


INFRASTRUKTURA

- Infrastruktura ekzistuese është joadekuate. Një numër i vogël i shtëpive të kësaj lagjeje është e kyçur në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Furnizimi me ujë të pijes është nga pusët individuale, ndërsa pjesa dërmuese e lagjes nuk është e kyçur në rrjetin e kanalizimit dhe këto ujëra fekale derdhen në afërsi të objekteve të banimit, përkatësisht në brendi të kësaj lagjeje. Zona është e furnizuar me energji elektrike dhe grumbullimi i mbeturinave bëhet nga shërbimet komunale.



*Përfundimi i
kanalizimit të qytetit
të Gjilanit afër lagjes
“Zabeli I Sahit
Agës”*

Vendbanimet Joformale



Rrezja e shërbimeve të infrastrukturës sociale në raport me vendbanimet joformale në qytetin e Gjilanit

KONSTATIMET NGJA HULUMTIMI

Të gjitha vendbanimet joformale në Kosovë, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga grupi për implementimin e standardeve për Kosovën. Por, megjithatë fillimi i rregullimit të tyre paraqet një veprim me të cilin jo vetëm që përmirësohet jeta e qytetarëve që jetojnë në to, por ai duhet edhe të dëshmojë efikasitetin e qeverisë lokale dhe asaj qendrore në ofrimin e shërbimeve themelore për qytetarët – infrastrukturën teknike dhe sociale.

Aktualizimi i problemit të vendbanimeve joformale ka ardhur në momentin e duhur, pikërisht para fillimit të përgatitjes së Planeve Rregulluese Urbane në Kosovë. Pa ndonjë analizë detaje, mund të përfundohet se shumica e vendbanimeve në Kosovë janë zhvilluar pa plane rregulluese urbane, ose planet kanë qenë të hartuara për pjesët e reja të qyteteve. Pjesët e vjetra të qyteteve si dhe pjesët periferike, për shkak të zhvillimit të hovshëm të vendbanimeve, urbanizmit intensiv si dhe periudhave të tranzicionit, nuk kanë mundur të zhvillohen me plane rregulluese. Prandaj, jo vetëm pjesët periferike të qyteteve, por edhe ato të indit urban duhet të jenë subjekt i planeve rregulluese për të:

- Konfirmuar pronësinë.
- Përmirësuar kushtet e infrastrukturës teknike dhe sociale.
- Organizuar banorët për pjesëmarrje në procesin e qeverisjes.
- Eliminuar rrezikshmërinë dhe diskriminimin e çfarëdo lloji.

Hulumtimi në katër qytetet zgjedhura, tregon se në përgjithësi në këto vendbanime janë prezentë: problemet e pronësisë, problemet e infrastrukturës joadekuate – prej mungesës së infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimit dhe furnizimit me rrymë e deri të mungesa e infrastrukturës sociale siç janë shërbimet e arsimit - shkollat, çerdhet, shërbimet themelore shëndetësore e të mos përmendim shërbimet e llojeve tjera – kultura, sporti dhe rekreacioni.

- Analizat nga terreni tregojnë se në lidhje me pronësinë në shumicën e rasteve, pronarë janë vet shfrytëzuesit e shtëpive – ndërtesave, megjithëse konfirmimi i pronës do të duhej të bëhet përmes dokumentacionit valid. Rastet e joposeditimit të tokës dhe uzurpimit janë të vogla dhe ato tashme janë në proces të zgjidhjes.
- Përveç vendbanimeve joformale në Gjakovë, ku shumica e banorëve furnizohen me ujë nga pusët, në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan, furnizimi është kryesisht nga ujësjellësi i qytetit, mirëpo edhe numri i banorëve të cilët furnizohen nga pusi nuk është i vogël. Në Prishtinë dhe Gjilan janë afërsisht gjysma e të intervistuarve që shfrytëzojnë ujin nga pusët.
- Largimi i ujërave të zeza, të më pak se gjysma e të intervistuarve, është në rrjetën e kanalizimit, kurse të tjerët ose në gropa septike ose në mënyrë joformale në lum/përrockë.
- Furnizimi me rrymë, në bazë të përgjigjeve është kryesisht formal, por ka mjaft edhe joformal. Kjo është një dukuri e cila duhet të merret parasysh edhe nga sistemi i furnizimit me rrymë i KEK.
- Rrjeti i telefonisë është shumë pak prezent, dhe këtij shërbimi pas luftës nuk iu ka kushtuar vëmendje e duhur.

Vendbanimet Joformale

- Largimi i mbeturinave është kryesisht i organizuar, përveç në disa raste kur vendbanimet nuk janë përfshirë në territorin urban – psh lagjia “Zabeli i Sahit Agës” në Gjiilan dhe “2 Korriku” në Mitrovicë, ku shumica largimin e mbeturinave e bëjnë në deponi joformale.
- Shërbimet themelore sociale – të arsimit parashkollor, shkollor dhe shëndetësia, përmes hartës tregojnë raportin e vendbanimit ndaj objekteve më të afërta ku realizohen shërbimet respektive.

Rezultatet detale të hulumtimit nuk kanë qenë në gjendje të prezentohen brenda raportit, por ato i janë bashkangjitur raportit në formë të tabelave dhe grafikoneve për mundësi të krahasimit.

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Hulumtimi i përfunduar lidhur me vendbanimet joformale në Kosovë, ka pasur për qëllim të përcaktojë gjendjen ekzistuese të vendbanimeve joformale në Kosovë. Po ashtu është tentuar që të krijohet një model i hulumtimit në mënyrë që zyrtarëve komunal t’u lehtësojë punën në hulumtimin e gjendjes ekzistuese dhe përcaktimin e prioritetëve për rregullimin e tyre.

Hulumtimi ka treguar se kriteret dhe treguesit e aplikuar janë efikas për të përcaktuar gjendjen ekzistuese të vendbanimeve joformale.

Në këtë hulumtim ka punuar një grup i profesionistëve, i kombinuar nga MMPH, Komunitat dhe UN-Habitati. Detyrat e pjesëmarrësve në grupet punuese kanë qenë të përcaktuara në bazë të obligimeve të punës në institucionet ku punojnë. Një pjesë e detyrës – hulumtimi në terren përmes një pyetësori, është kryer nga studentë të Seksionit të Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës.

REKOMANDIMET PËR HARTIMIN E UDHËZUESIT

Udhëzuesi duhet të:

- Ofrorë kornizën dhe kriteret e përcaktimit të vendbanimeve joformale – identifikimin dhe klasifikimin si dhe prioriteti në kuadër të planeve zhvillimore urbane dhe komunale
- bazohet në parimet e planifikimit hapësinor – Respektimi i parimeve nga niveli lokal deri te ai global siguron se procesi i planifikimit dhe rregullimit do të respektojë standardet ndërkombëtare.
- sygjerorë kriteret për vendbanimet joformale, prioritare për formalizim dhe rregullim
- sygjerorë metodologjinë e procesit të planifikimit dhe pjesëmarrësit në proces
- propozojë mënyrën e financimit të formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale
- të udhëzojë mënyrën e informimit dhe komunikimit (krijimi i databazës së vendbanimeve joformale, komunikimi me pjesëmarrësit dhe publikun etj.)
- Si pjesë e udhëzuesit duhet të parashifen pilot projekte të formalizimit dhe rregullimit për lloje të vendbanimeve joformale, varësisht prej interesit të komunave dhe donatorëve

REKOMANDIMET PËR KOMUNAT

Profili i vendbanimeve joformale - Komunitat duhet të përgatisin profilin e gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e tyre. Kjo do t’u shërbente për të përcaktuar prioritetet e rregullimit të vendbanimeve joformale, kurse donatorëve të mundshëm do t’u ofronte informata të nevojshme për nevojën e përkrahjes financiare, humane dhe teknike në rregullimin e tyre.

Shërbimet e kadastrit dhe pronës duhet të sigurojnë planet gjeodezike dhe shënimet pronësore nëmënyrë që saktësia e informatave të mos paraqesë problem për planifikim.

Çështja e pronës: nevojitet një angazhim intensiv i komunave për të përcaktuar të drejtat pronësore. Të gjitha dokumentet e nevojshme pronësore duhet të mblidhen dhe verifikohet validiteti i tyre.

Çështjet e pazgjidhura pronësore duhet të zgjidhen në mënyrë që të krijohet baza ligjore për fillimin e procesit të planifikimit.

Procesi i planifikimit - Rregullimi i vendbanimeve joformale duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësi të artikulojnë kërkesat e tyre dhe marrja e vendimeve të jetë transparente. Për këtë qëllim duhet të organizohen banorët e vendbanimeve të tilla, që të jenë të gatshëm të kyçen në proces, përmes të zgjedhurve të komunitetit apo pjesëmarrjes së të gjithëve.

Bashkëpunimi me AKM – për të evituar problemet lidhur me tokën publike e cila menaxhohet nga AKM, e nevojshme për shërbime, duhet të diskutohet me AKM dhe të gjenden zgjidhje për sigurimin e këtyre hapësirave – shkolla, çerdhe.

SFIDAT

Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale që do të duhej të jete komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate të rregullimit të vendbanimeve joformale në Kosovë.